

**PROF.DR.HFZ  
HAJREDIN HOXHA**

**KULTURAE  
MUSLIMANIT**  
*Bashkëkohor*



Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

# **KULTURA E MUSLIMANIT BASHKËKOHOR**

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Dr. Hajredin HOXHA

**KULTURA E MUSLIMANIT BASHKËKOHOR**

(përvojë personale në dritën e ajeteve kur'anore)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.  
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

**PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:**

**Sedat ISLAMI**

**Titulli në origjinal:**

Dr. Hajruddin Huxheh,

*Thekafetu el-muslimi el-muasir – texhribetun shahsijjetun fi dau’i el-Kur’ani ve-s-Sunneh.*

Dr. Hajredin HOXHA

**KULTURA E MUSLIMANIT BASHKËKOHOR**

(përvojë personale në dritën e ajeteve kur'anore)

## **Përmbajtja:**

Hyrje

Rëndësia e punimit

Problematika e punimit

Punimet preliminare

### **I. HYRJE RRETH KULTURËS ISLAME**

I.1. Definicioni i kulturës, lidhja me dijen dhe civilizimin si dhe dallimi ndërmjet saj dhe kulturave të tjera

I.2. Lidhjet e kulturës me fenë, dijen, civilizimin, qytetërimin si dhe rezultatet përkatëse

I.3. Rëndësia e kulturës islame

I.4. Dallimi ndërmjet kulturës islame dhe kulturave të tjera dhe shkaqet e ndryshimit kulturor

### **II. BURIMET E INTELEKTUALIT MUSLIMAN MODERN**

II.1. Kur'ani Fisnik

II.2. Sunneti pejgamberik

II.3. Mendimi dhe trashëgimia islame

### **III. BAZAT DHE KARAKTERISTIKAT E KULTURËS SË MUSLIMANIT MODERN**

III.1. Bazat

III.2. Karakteristikat kulturës së muslimanit modern

### **IV. VEÇORITË E KULTURËS SË MUSLIMANIT MODERN**

### **V. LIDHJET E KULTURËS SË MUSLIMANIT MODERN ME KULTURAT**

E TJERA

VI. ARGUMENTET E TRANSPARECËS (TË QENIT I HAPUR) NË  
KULTURËN E MUSLIMANIT MODERN

VII. KRITERET DHE KUSHTET E TË QENIT I HAPUR

Përmbyllja dhe konkluzionet

Bibliografia

## Parathënie

---

Falënderimet i takojnë Allahut! Përshëndetjet, paqja, mëshira dhe mirësitë qofshin mbi Muhammedin, familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

I jam mirënjohës dhe shumë falënderues Allahut të Plotfuqishëm, i Cili më nderoi kur më mundësoi marrjen e diturisë nga Qyteti i bekuar i Resulullahit [alejhis salatu ves selam], sikur që më nderoi prapë, kur u caktova edhe për të dhënë dije në Medinën e bukur, respektivisht në Universitetin Tajjiba. Atje qëndrova për një kohë të gjatë, ku ligjërova lëndë të ndryshme fetare, në mesin e të cilave edhe lëndën e ‘Kulturës Islame’, lëndë të cilën vazhdoj ta ligjëroj edhe këtu në Katar, ku aktualisht jam i angazhuar si ligjërues. E kam dhënë si lëndë për nivele të ndryshme universitare, andaj edhe kam fituar një përvojë, të cilën, në këtë punim, të dashur lexues, desha ta ndaj me ju.

Allahu i Madhëruar e dërgoi Muhammedin [alejhis salatu ves selam] me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, e dërgoi për të triumfuar mbi të kotën dhe për të nxjerrë njerëzimin nga errësira në dritë.

الرَّ كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ

الْحَمِيدِ ﴿١﴾

*Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit.” (Ibrahim, 1)*

Historia ka regjistruar se njerëzit në Gadishullin Arabik, para ardhjes së Islamit, ishin të zhytur thellë në humnerën e idhujtarisë dhe paganizmit. Ata adhuronin idhuj, puta, statuja, ndërsa i përuleshin edhe diellit dhe hënës.

وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ ۚ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي

خَلَقَهُمْ ۚ إِنَّ كُنْتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٢٧﴾



*Nga faktet e madhështisë së Tij janë nata, dita, dielli e hëna. Mos i bëni sexhde as diellit, as hënës! Sexhde bëjini vetëm All-llahut, i Cili i krijoi ato, nëse e adhuroni vetëm Atë!” (Fussilet, 37)*

Ishte caktimi dhe vullneti i Allahut që feja e Tij të përhapet në Lindje dhe Perëndim, dhe këtë në saje të angazhimit të palodhshëm dhe sakrificës sublime të sahabëve [Allahu qoftë i kënaqur me ta!], tabiinëve si dhe besimtarëve të tjerë të sinqertë, thirrës dhe tregtarë. Si rezultat, shumë njerëz e pranuan Islamin dhe shpëtuan nga humbja dhe devijimi.

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ ﴿١﴾ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا ﴿٢﴾ فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ  
وَأَسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا ﴿٣﴾

*Kur erdhi ndihma e All-llahut dhe çlirimi (ngadhënjimi), 2. Dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë e All-llahut. 3. Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është mëshirues i madh.” (en-Nasr, 1-3)*

## **Rëndësia e punimit**

Rëndësia e këtij punimi, në vllugun e këtyre zhvillimeve të mëdha fetare dhe politike si dhe në kohën e globalizimit shoqëror, kulturor dhe ekonomik, qëndron në faktin se ai është produkt i një përvoje personale, teorike dhe praktike, të cilën e kam përjetuar unë, si autor i këtyre rreshtave.

Sa i përket aspektit teorik, atë e kam përmendur në parathënie (ku nënvizova angazhimin tim si profesor), ndërsa sa i përket aspektit praktik, ai ka të bëjë me përgatitjen profesionale të autorit, i cili personalitetin e tij e formoi nga përfitimi i dijes në institucione të ndryshme, të njohura në mbarë botën, sikurse që formimin mendimtar, kulturor dhe fetar, pas ndihmës dhe begative të Allahut, e realizoi edhe falë mbështetjes në baza shkencore, ideore dhe metodologjike. Shkollimin fillor e kam marrë në vendlindje, Kosovë, për të vazhduar më pas me shkollimin e mesëm në Damask, Siri, pastaj atë universitar në Medinën e Ndrithme, ndërsa studimet postdiplomike i kam vazhduar në Kuala Lumpur, Malajzi. Gjatë kësaj periudhe dhe përvoje, njëkohësisht, kam vënë re se kultura e

muslimanit, pavarësisht se ku është, duhet të jetë në përputhje me rregullat, të cilat gjithsesi do t'i përmend më vonë.

### **Problematika e hulumtimit**

Problematika e këtij punimi ka të bëjë me diskutimet e mendimtarëve dhe intelektualëve muslimanë për hapjen totale ndaj botës apo mbylljen hermetike në vete. Kjo për shkak se globalizmi botëror dhe lufta ideore dhe kulturore në nivel global synojnë jo vetëm afrimin por edhe shkrirjen e dallimeve ekonomike, kulturore, ideore dhe fetare. Kjo, sipas tyre, nënkupton hapje të pakushtëzuar e të pakontrolluar. Sigurisht, rreziqet e kësaj hapjeje janë të mëdha dhe për këtë shkak mendimtarët dhe intelektualët muslimanë hezitojnë të hedhin hapin në këtë drejtim, ngase i druhen shkrirjes dhe asimilimit total apo të pjesshëm në këto kultura. Kësisoj, ata jo vetëm që nuk i përqafojnë por edhe bëjnë thirrje që t'u mbyllen të gjitha dyert këtyre ideve, ngase rezistimi është i pamundur, andaj edhe preferojnë izolimin. Kjo shtron pyetjen: cili nga këto grupe e ka më mirë dhe mendimi i cilit grup duhet përqafuluar? Atyre që thërrasin për hapje të përgjithshme kulturore apo të këtyre që duan izolim total?<sup>1</sup>

Ky studim mëton të hedhë dritë mbi disa pyetje që kanë të bëjnë me kulturën e muslimanit modern nga perspektiva e burimeve, veçorive, shenjave, rëndësisë, lidhjeve dhe raporteve me kulturat e tjera, argumenteve të hapjes kulturore të kontrolluar dhe jo të kontrolluar, duke i dëshmuar këto me ajete kur'anore, hadithe pejgamberike dhe thënie të dijetarëve. Sigurisht, një punim si ky nuk do të mund të trajtonte tërë atë që ka të bëjë me këtë temë, por mua më mjafton që është një përpjekje serioze, e çiltër dhe e sigurtë në këtë drejtim.

### **Studimet preliminare**

Gjatë kohës që kam dhënë lëndën e Kulturës Islame, respektivisht kur përgatitja ligjëratat, kam vënë re disa gjëra, të cilat i kam nënvizuar si të papranueshme dhe, rrjedhimisht, jo çdo gjë që përmendej në ato burime duhej marrë si mbështetje. Sigurisht, shkak për këtë është diskutimi për Kulturën Islame nga këndvështrime të ndryshme. Disa prej autorëve fokusoheshin vetëm në

---

<sup>1</sup> Shih: Kardavi, Jusuf. *Thekafetuna bejne-l-infitahi ve-l-ingilak*, f. 11. Shih po kështu: Halidi dhe të tjerë. *El-vexhizu fi-th-thekafeh*, f. 178-211.

elementin arab, duke harruar elementin universal të kulturës islame, ndërsa në anën tjetër, gjeje autorë që ndiqnin ekstreme të tjera, duke anashkaluar plotësisht elementet lokale – traditat dhe të veçantat e popujve, për të harruar kështu se ajo që mund të jetë e pranueshme për mekasit dhe medinasit, mund të mos jetë e pranueshme për londinezët, parisienët etj. Po kështu, edhe e kundërta.

Për këtë shkak pasoi edhe ky punim, qëllimi primar i të cilit është rikthimi i vlerësimit dhe kriterit shkencor dhe fetar, fatkeqësisht inekzistent tani për tani në metodologjitë dhe punët tona. Dijetarët e gjeneratave të mëhershme nuk kanë veçuar ndonjë libër me këtë tematikë, porse na kanë pajisur me rregulla dhe kritere shkencore, nëpërmjet të cilave arrijmë të zbulojmë objektivat e pastra islame, të cilat vlejné në çdo kohë, për çdo popull dhe për çdo vend, natyrisht duke pasur parasysh parimet e pandryshueshme të besimit, moralit dhe dispozitave fetare si dhe ato të ndryshueshme, që janë çështje dytësore dhe të cilat ndryshojné me ndryshimin e kohës dhe vendit.

Për këtë shkak, ne nuk mund ta pranojmë tërë atë që na servohet në këto studime bashkëkohore, sikurse që nuk mund t'i mohojmë tërësisht ato. Ajo që duhet të bëjmë është rishqyrtimi i shumë çështjeve që kanë të bëjnë me kulturën, sipas rregullave dhe parimeve, kuptohet duke ruajtur etikën dhe moralin me të gjithë, si dhe ndjekjen e një metodologjie mesatare, e cila mua, personalisht, më ka garantuar një pozitë të respektuar tek dijetarët dhe mendimtarët. Fakti se i jam përmbajtur kësaj vije mesatare dhe kam ecur i sigurt sipas saj, ka bërë që unë të mos marr kritika nga dijetarët, thirrësit apo kolegët e mi në universitete. E falënderoj Allahun për këtë mirësi!

# Kapitulli I:

## HYRJE RRETH KULTURËS ISLAME

---

### I. 1. DEFINICIONI I KULTURËS DHE RAPORTET E SAJ ME DIJEN DHE CIVILIZIMIN SI DHE DALLIMI NDËRMJET SAJ DHE KULTURAVE TË TJERA

#### I.1.1. DOMETHËNIA E KULTURËS

##### I.1.1.1. Domethënia etimologjike

Hulumtuesit dhe mendimtarët nuk ndajnë mendime të njëjtë sa i përket termit 'kulturë' dhe përdorimit të tij. Në gjuhën arabe, kultura (ar. *eth-thakafetu*) ka disa kuptime:

Rrjedh nga rrënja foljore *the-ka-fe* (ar. *ثَقَفَ*) që ka kuptimin e shkathtësisë, gdhendjes, ndreqjes, korrigjimit, rishqyrtimit (ar. *hadheka ve hedh-dhebe*). Thuhet: *rexhulun thakfun* (ar. *ورجل ثَقَفٌ*) burri i zgjuar. Kjo nënkupton zgjuarsinë dhe shkathtësinë në të nxënit (kuptuarit) e gjërave dhe çështjeve.

Domethënia e kësaj fjale (ar. *thekafe*) më pas ka marrë edhe kuptimin e ngadhënjimit dhe mbizotërimit, siç qëndron në ajetet kur'anore:

وَأَقْتُلُوهُمْ حَيْثُ ثَقِفْتُمُوهُمْ وَأَخْرِجُوهُمْ مِّنْ حَيْثُ أَخْرَجُوكُمُ ۚ وَالْفِتْنَةُ أَشَدُّ مِنَ الْقَتْلِ ۗ وَلَا تُقْبِلُوهُمْ عِنْدَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ حَتَّىٰ يُقْبَلُوكُمْ فِيهِ ۗ فَإِن قَاتَلُوكُمْ فَاقْتُلُوهُمْ ۗ كَذَٰلِكَ جَزَاءُ الْكٰفِرِينَ



*Dhe luftoni ata kudo që t'i zini, dëboni prej vendit ata sikurse ju përzunë ata juve. Provokimi (fitneja) është më i rëndë se vrasja. Mos i luftoni ata pranë xhamisë së shenjtë (Qabesë) deri që ata t'ju luftojnë juve aty, e nëse ju sulmojnë, atëherë sulmoni edhe ju ata. I këtillë është ndëshkimi ndaj mosbesimtarëve.” (el-Bekare, 191)*

فَأَمَّا تَتَقَفَّهِمْ فِي الْحَرْبِ فَشَرِّدْ بِهِمْ مَنْ خَلْفَهُمْ لَعَلَّهُمْ يَدْكُرُونَ ﴿٥٧﴾

*Po nëse i ndesh (i zë) ata në luftë, atëherë ti me ta (me shkatërrimin e tyre) shpartallo ata që të marrin mësim.*“ (el-Enfalë, 57) <sup>2</sup>

Fjalorët gjuhësorë na japin edhe shpjegime të tjera, respektivisht për përdorimin material të saj, duke marrë si shembull këtu fjalën *eth-thikaf* (لِثِقَافٍ) që emërton një lloj hekuri, me të cilin drejtohet një gjë e shtrembëruar. Po kështu aludojnë dhe për domethëniet abstrakte, që kanë të bëjë me domethëniet që përmendëm më parë, pra të zgjuarsisë, mësimi, të kuptuarit. Thuhet: *tethkif el-ukul ve-l-efkar el-muavvexheh* me kuptimin e edukimit, arsimimit dhe shkollimit. Thuhet, po kështu: *thekkafe el-ustadhu et-tilmidhe* – mësuesi e ka edukuar, shkolluar dhe mësuar nxënësin<sup>3</sup>.

#### I.1.1.2. Domethënia terminologjike

Përkitazi me domethënien dhe kuptimin e termit ‘kulturë’ janë dhënë mendime të ndryshme, si:

*“Marrja (mësimi) e një pjese (të përgjithshme) nga çdo shkencë, duke mos synuar thellimin, zhytjen dhe specializimin në to. Thuhet: Po deshe të jesh i kulturuar, mëso diç nga çdo gjë, ndërsa po deshe të jesh dijetar, atëherë mëso gjithçka për çdo gjë.”*

*“Njeriu nuk mund të jetë i kulturuar dhe as të zhytet në studimin e shkencave dhe arteve nëse paraprakisht nuk është i zgjuar, nëse nuk dallohet për shpejtësi në të nxënit e gjërave si dhe nëse nuk shquhet për kuptimin thelbësor të tyre.”*

Pas konsultimit të këtyre dhe definicioneve të tjera të kulturës, mendojmë se definicioni me një kuptim më të përmbledhur dhe më të fortë është:

*“Kultura është një mori besimesh (bindjesh) dhe perceptimesh, normash dhe dispozitash, vlerash dhe parimesh, zakonesh dhe traditash, artesh dhe edukatash, si dhe shkencash të zbuluara, të cilat, në përputhje me principet dhe parimet e Islamit, formësojnë personalitetin e individit dhe identitetin e ummetit.”* <sup>4</sup>

<sup>2</sup> El-Eshkar, Omer Sulejman. *Nahve thekafetin islamijetin esileh*, f. 4.

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Shih: Badehdah, Ali Umer dhe të tjerë. *Eth-thekafetu el-islamijeh*, f. 15.

## I.1.2. RAPORTET E KULTURËS ISLAME ME FENË, SHKENCËN, CIVILIZIMIN, QYTETËRIMIN DHE REZULTATET QË DALIN PREJ KËTYRE RAPORTEVE

Kultura Islame është e mishëruar me Fenë Islame, kështu që, atë që e pranon feja, e pranon edhe ajo, dhe atë që e refuzon feja, e refuzon edhe ajo. Traditat, doket, zakonet si dhe disa sisteme të vëna nga njeriu kushtëzohen që të jenë në përputhje të plotë me parimet islame, ndryshe refuzohen. Nga këtu, Kultura Islame është një imazh lëvizës – nëse mund të shprehemi kështu – i Fesë Islame dhe praktikimit të saj në jetën e përditshme. Atëherë, fryt i kësaj çështje do të ishte se Islami është referenca dhe kriteri i kësaj kulture; atë që e refuzon feja, e refuzon edhe kultura. Ajo që dua të them është se aplikimi i kodit të kulturës islame<sup>5</sup> nënkupton adhurimin për Allahun, Zotin e botëve.

Por, cili është dallimi ndërmjet kulturës dhe dijes?

Dallimi ndërmjet kulturës dhe dijes është se kultura është më e veçantë, për shkak të të qenit të saj si një veçori dhe karakteristike e një populli të caktuar, ndërsa dija është diç e përgjithshme, që nuk shquhet me një popull dhe jo me popullin tjetër. Dija, po kështu, është produkt njerëzor i përbashkët, që nuk ka identitet të caktuar. Dija është rezultat i eksperimenteve, rezultatet e së cilës janë të njëjta, gjë që nënkupton se nuk ndikohet nga ideja apo emocioni<sup>6</sup>.

Ndërsa sa i përket termit ‘civilizim’ (ar. *el-hadare*), arabët<sup>7</sup> me të nënkuptojnë të kundërtën e fshatarësisë: i civilizuar është ai që nuk është fshatar, ai që banon në qytet. Ndërsa në terminologji, ka dy qasje rreth definimit të këtij termi:

Civilizimi është sinonim i kulturës. Civilizimi është shpirti i thellë i shoqërisë, që ngrihet mbi bazën e konfirmimit të origjinalitetit shpirtëror dhe të vërtetës filozofike dhe emocionale të njeriut.

Sipas kësaj domethënie, civilizimi nuk përfshin aspektin industrial dhe material. Kësisoj, civilizimi është sinonim i kulturës.

Sipas qasjes së Shkollës Franceze, e cila parasheh ndarjen ndërmjet asaj që është

---

<sup>5</sup> Seid, Hemmam & Halidi, Salah. (2002) *El-voxhiz fi-th-thekafeti-l-islamijeh*, f. 28-29.

<sup>6</sup> Shih: Badehdah, Ali Umer dhe të tjerë. *Eth-thekafetu el-islamijeh*, f. 15.

<sup>7</sup> Ibni Mendhur, Xhemaluddin Ibn Mukrem. (...) *Lisanu-l-arab*. Rrënja foljore *ha-da-re*.

ideore dhe teknologjike në shoqëri, të gjitha këto emërtohen me një emër: qytetërim (ar. *el-medenijeh*). Sipas tyre, nuk ka dallim ndërmjet kulturës dhe qytetërimit.

Këtë botëkuptim e kanë përqafuar shumë prej autorëve, perëndimorë dhe muslimanë, që kanë shkruar për kulturën, si: Gustav Le Bon, William James Durant, Hasen Ibrahim Hasen, Mustafa Sibai etj. Këta e marrin kulturën si diç që përfshin aspektin ideor dhe material të shoqërisë.

Pas studimit dhe analizave që iu kemi bërë mendimeve të ndryshme rreth kulturës, kemi ardhur në përfundimin se:

*“Kultura e një shoqërie është kombinim besimesh, sistemesh, sjelljesh, zakonesh, zhvillimesh shkencore dhe teknologjike si dhe metodash dhe mjetesh.”*<sup>8</sup>

Ndërsa, me ‘Kulturën Islame’ nënkuptojmë:

*“Besimin (kredon) e Islamit, dispozitat, etikën, sistemet politike, ekonomike dhe shoqërore si dhe mënyrat e muslimanëve për të vënë në funksionim ambientin, ku bëjnë pjesë metodat, mjetet dhe zbulimet industriale.”*<sup>9</sup>

Ndërsa sa i përket termit ‘qytetërim’, nga pikëpamja gjuhësore i atribuohet qytetit, ndërsa nga pikëpamja terminologjike ka dy domethënie:

-Qytetërimi përkufizohet vetëm në aspektin material të jetës, pra është manifestim i zhvillimit urban dhe teknologjik.

-Qytetërimi emërton njëkohësisht aspektin ideor dhe atë material.

Kështu, qytetërimi na del si:

*“Tërësi e kombinuar në një shoqëri nga besimet, morali, zakonet, sjelljet, zhvillimi teknologjik dhe material si dhe metodat dhe mjetet.”*<sup>10</sup>

Si rezultat të këtyre dallimeve në definicione kemi:

- 1) Kultura nënkupton aspektin e vlerave, sjelljeve dhe aspektin shoqëror të

---

<sup>8</sup> Shih: Badehdah, Ali Umer dhe të tjerë. *Eth-thekafetu el-islamijeh*, f. 20-24.

<sup>9</sup> Halidi, Salah. (2002) *El-vexhiz fi-th-thekafeti-l-islamijeh*, f. 29-30.

<sup>10</sup> Ibid.

shoqërisë.

- 2) Civilizimi përfshin aspektin material-industrial të shoqërisë, duke përfshirë mjetet dhe metodat e dobishme.
- 3) Qytetërimi është nocion që përfshin aspektet e termave të mëparshëm, kulturës dhe civilizimit. Është sikur të thuash bashkim i trupit me shpirtin.

Kjo përputhshmëri nënkupton se çdo popull ka qytetërimin e vet me të cilin shquhet nga të tjerët. Qytetërimi shqiptar është i ndryshëm nga ai boshnjak, qytetërim turk është i ndryshëm nga ai indian, qytetërimi melaj është i ndryshëm nga ai kinez etj.<sup>11</sup>

### I.1.3. RËNDËSIA E KULTURËS ISLAME

Dr. Jusuf Kardavi, duke folur për rëndësinë e kulturës, thotë: "...popujt, sigurisht, dallojnë shumë në kulturë nga njëri-tjetri. Ka prej tyre kultura e të cilëve është e drejtuar nga shpirti (spiritualiteti), të tjerë kultura e të cilëve është e drejtuar nga mendja (logjika) e disa të tjerë kultura e të cilëve është e drejtuar nga materializmi. Ka popuj kultura e të cilëve është e lidhur me tokën, sikurse që ka të tjerë kultura e të cilëve është e lidhur me qiellin. Prej tyre ka që e njohin Allahun për Krijues, por nuk e adhurojnë; të tjerë që e adhurojnë por nuk e aplikojnë ligjin e Tij në jetën e përditshme, e prej tyre ka që i kanë bashkuar të gjitha këto elemente: nuk kërkojnë zot pos Allahut, nuk adhurojnë askënd përveç Tij, si dhe nuk marrin Ligjvënës askënd pos Tij."<sup>12</sup>

Bazuar në këtë, rëndësinë e Kulturës Islame do të mund ta kuptonim nëpërmjet pikave në vijim:

**-Dallueshmëri në identitet dhe principe.** Muslimani intelektual dallohet nga intelektualët e tjerë në të gjitha fushat e jetës. Ai dallohet në moral, sjellje, marrëdhënie, mënyrën e të ngrënit, pirjes etj. Ai nuk asimilohet, pavarësisht se sa gjatë mund të jetojë në një shoqëri tjetër. Është kultura e tij ajo që e ruan atë nga shkrirja. Kur'ani Fisnik ka aluduar për këto tipare të çmuara. Allahu i

---

<sup>11</sup> Ibid. F. 30-31.

<sup>12</sup> Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, f. 19.



Madhërishëm thotë:

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا وَإِذَا خَاطَبَهُمُ الْجَاهِلُونَ قَالُوا سَلَامًا ﴿٦٣﴾

*E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe!" (el-Furkan, 63)*

وَلَا تَسْتَوِي الْحَسَنَةُ وَلَا السَّيِّئَةُ ۗ ادْفَعِ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ فَإِذَا الَّذِي بَيْنَكَ وَبَيْنَهُ عَدَاوَةٌ كَأَنَّهُ وَلِيٌّ

حَمِيمٌ ﴿٦٤﴾

*Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt."*

(Fussilet, 34)

**-Rrënjët e thella dhe lidhjen me të kaluarën.** Kultura Islame është kulturë rrënjët e së cilës janë të ngulitura thellë. Ajo lidhet fuqishëm me të kaluarën e bujshme të saj, me historinë e ndritur islame. Ajo, në të njëjtën kohë, është kulturë e trashëguar dhe e përfituar. E trashëguar nga prindërit dhe ambienti, dhe e përfituar nga të mësuarit dhe kultura. Allahu ka thënë:

﴿ شَرَعَ لَكُمْ مِنَ الدِّينِ مَا وَصَّىٰ بِهِ نُوحًا وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ أَنْ أَقِيمُوا الدِّينَ وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ ۗ

*Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të... "* (esh-Shura, 13)

وَجَاهِدُوا فِي اللَّهِ حَقَّ جِهَادِهِ ۗ هُوَ اجْتَبَاكُمْ وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ ۗ مَلَّةً أَبِيكُمْ إِبْرَاهِيمَ ۗ هُوَ سَمَّاكُمُ الْمُسْلِمِينَ مِنْ قَبْلُ وَفِي هَذَا لِيَكُونَ الرَّسُولُ شَهِيدًا عَلَيْكُمْ وَتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ ۗ

فَأَقِمْوَا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَاعْتَصِمُوا بِاللَّهِ هُوَ مَوْلَاكُمْ ۗ فَنِعْمَ الْمَوْلَىٰ وَنِعْمَ النَّصِيرُ ﴿٦٥﴾

*Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur'an) ju quajti*

*muslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbajuni All-llahut se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtar i madh që është.”* (el-Haxh, 78)

**-Mburria dhe krenaria për përkatësinë kulturore.** Muslimani i kulturuar ndien në shpirt një lloj krenarie dhe mburrje, sigurisht jo të tipit arrogant, nënçmues dhe ofendues për të tjerët, por krenari për faktin se i përket një feje të madhe, një feje kulturaliste, një feje me përkatësinë e së cilës ndihet i lumtur. Allahu ka thënë:

❖ *وَلِلَّهِ الْعِزَّةُ وَلِرَسُولِهِ وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَلَكِنَّ الْمُنَافِقِينَ لَا يَعْلَمُونَ...*

*" Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë ".* (el-Munafikune, 8)

**-Aftësia e bashkëveprimit me aktualitetin.** Kultura Islame ka qasje pozitive për jetën. Islami e urdhëron njeriun të punojë në tokë dhe ta ndërtojë atë, duke përfillur kodin gjeneral, i cili është i shprehur në këto ajete kur'anore: "

❖ *إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ*

*يَعْظُمُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ* ﴿٥٦﴾

*All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”* (en-Nahl, 90)

*وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ ۗ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۗ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ*



*... Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.”* (el-Maide, 2)

#### I.1.4 DALLIMI NDËRMJET KULTURËS ISLAME DHE KULTURAVE TË TJERA SI DHE SHKAQET E NDRYSHIMIT KULTUROR

Ummeti Islam ka kulturën, e cila e formëson personalitetin e individit dhe shoqërisë si dhe e bën atë të dallohet nga popujt e tjerë. Distancimi nga kultura dhe ligjet e veta do ta arkivonte Ummetin Islam në sirtarët e pluhurosur të historisë. Muslimanët, pa fenë dhe kulturën e tyre, janë asgjë. Ndërsa sa i përket kulturave të tjera, puna qëndron ndryshe. Përderisa janë të krijuara nga njeriu, atëherë ka mundësi që në to të ketë të mira dhe të këqija, të qëlluara dhe të gabuara. Ndosht, madje shumë shpesh, që për shkak të kësaj natyre ato të kenë kundërthënie të mëdha, pikë kjo që evidenton dobësinë dhe avarinë e këtyre kulturave.<sup>13</sup> Allahu i ka qortuar ata që kërkojnë udhëzime dhe burime për ligjet e tyre tjetërkund përveç Islamit. Ai ka thënë:

أَفْحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ<sup>ع</sup> وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِقَوْمٍ يُوقِنُونَ ﴿٥٠﴾

*“A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?” (el-Maide, 50)*

وَأَنْ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ<sup>ط</sup> وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَن سَبِيلِهِ<sup>ع</sup> ذَٰلِكُمْ وَصَّاكُم بِهِ<sup>ع</sup>  
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٥٣﴾

*“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.” (el-En'amë, 153)*

<sup>13</sup> Ferraxh, Ahmed dhe të tjerë. *Hasaisu-th-thekafeti-l-arabijjeti ve-l-islamijeh*, f. 5-17; Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, f. 19-22; Kardavi, Jusuf. (2010) *Thekafetu-d-daijeh*, f. 141-145.

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا



*“Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.” (el-Isra, 9)*

يَتَأْهَلُ الْكِتَابِ لِمَ تَلْبِسُونَ الْحَقَّ بِالْبَاطِلِ وَتَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ

*“O ithtarët e librit, përse, duke qenë se ju e dini të vërtetën e ngatërroini me gënjeshtren dhe e fshihni realitetin?” (Ali Imran, 71)*

Nga ajetet e mësipërme kuptojmë se muslimani është i obliguar (urdhëruar) të pasojë programin hyjnor, që është i shprehur në Kur'an dhe Sunnet, në jetën e tij publike dhe private. Ajetet, po kështu, flasin edhe për vlerën e Kur'anit dhe rëndësinë e tij në udhëzimin e njerëzve në atë që është më e mira, sikurse që shpalosin të vërtetën përkitazi me Ithtarët e Librit, respektivisht idetë dhe bindjet e tyre.

Shumë dijetarë dhe mendimtarë mbrojnë mendimin se kulturat e popujve të tjerë janë subjekte me mundësi ndryshimi dhe zhvendosjeje (zëvendësimi). Kjo është një e vërtetë historike, e dëshmuar në të kaluarën dhe tanishmen. Kjo gjë ndodhi në arkipelagun melaj, gjatë sundimit të kolonialistëve portugezë dhe spanjollë. Këtë të vërtetë e kemi vërejtur edhe në shek. e XX-të në vendet që kanë vuajtur nga luftërat e brendshme dhe nga kolonizimet<sup>14</sup>, siç ishte për shembull fati i BeH-së dhe Kosovës, në të cilat ndryshimi kulturor erdhi si pasojë e përhapjes së kulturës së demokracisë, ofrimit të ndihmave nga KB-ja si dhe nga shoqatat misionare, e po kështu dhe nga forcat paqësore shumetnike që veprojnë dhe operojnë (vepruan dhe operuan) në këto vende. Pas mbarimit të luftës, kemi parë dukuri degjeneruese tek muslimanët e këtyre vendeve, dukuri këto të vëna re edhe në Lindjen Arabe gjatë kolonizimit anglez dhe francez. Këto dukuri janë

<sup>14</sup> Xhurejsheh, Ali. (1979) *Esalibu-l-gazvi-l-fikrijj li-l-alemi-l-islamijj*, f. 70-74.

vënë re, po kështu, edhe pas rënies së Perandorisë Osmane, sikurse që janë vënë re edhe kohëve të fundit në Afganistan, Irak, e edhe në vendet e Pranverës Arabe. Konsideroj se ia vlen shumë të shkëpus një paragraf nga fjalët e bukura të thëna nga rahmetliu Omer Sulejman el-Eshkar, i cili në librin ‘Nahve thekafetin islamijetin esileh’ thotë:

“Kulturat e popujve janë subjekte ndryshimi dhe zhvendosjeje. Islami e ndryshoi kulturën e arabëve paraislamikë, ndërsa të krishterët e ndryshuan kulturën e muslimanëve. Ndryshimi kulturor ka disa shkaqe, si: bindjen e një populli apo një grupi të caktuar njerëzish për të përqafuar fenë apo kulturën e një populli tjetër, ashtu siç ndodhi me arabët dhe popujt e tjerë që përqafuan Islamin; ushtrimi i ndikimit të liderëve dhe shkencëtarëve, siç ndodh në Perëndim, ku për pasojë sot, p.sh. aborti, prostitucioni, homoseksualizmi, lesbicizmi, shkurorëzimi, etj., janë të lejuara. ”<sup>15</sup>

Kur’ani Famëlartë ka aluduar për këtë lloj kolonialistësh. Allahu ka thënë:

قَالَتْ إِنَّ الْمُلُوكَ إِذَا دَخَلُوا قَرْيَةً أَفْسَدُوهَا وَجَعَلُوا أَعْرَظَ أَهْلِهَا أُذِلَّةً ۗ وَكَذَلِكَ يَفْعَلُونَ ﴿١٤٧﴾

*“Ajo tha: "Kur sunduesit e pushtojnë ndonjë vend, ata e rrënojnë atë e parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu ata veprojnë!"*” (en-Neml, 34)

إِنَّ فِرْعَوْنَ عَلَا فِي الْأَرْضِ وَجَعَلَ أَهْلَهَا شِيَعًا يَسْتَضِعُّ طَائِفَةً مِّنْهُمْ يُذَبِّحُ أَبْنَاءَهُمْ وَيَسْتَحْيِي نِسَاءَهُمْ إِنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ ﴿١٧٠﴾

*Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kokën lart në tokë, e popullin e saj e grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve.”* (el-Kasas, 4)

قَالُوا يَبْنَؤُا الْقَرْيَاتِ إِنَّ يَأْجُوجَ وَمَأْجُوجَ مُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ فَهَلْ نَجْعَلُ لَكَ خَرْجًا عَلَىٰ أَنْ تَجْعَلَ

<sup>15</sup> El-Eshkar, Omer Sulejman. (2001) *Nahve thekafetin islamijetin esileh*, f. 33-34.

*Ata thanë: "O Dhulkarnejn, vërtet Jexhuxhi dhe Mexhuxhi janë duke bërë shkatërrime në tokë, a bën që ne të japim ty një kontribut (në formë tagri a tatimi), e që të bësh një pendë mes nesh dhe mes tyre?"*" (el-Kehf, 94)

Aspekti i argumentimit nga ajetet e mësipërme është konfirmimi i shkaktimit të trazirave dhe shkatërrimit si cilësi e përhershme e shkatërrimtarëve, mendjemëdhenjve dhe pushtuesve.

Sa i përket ndryshimit kulturor që Islami bëri tek popujt, ky ndryshim ishte i madh, ndërsa ato që nuk pësuan ndryshime ishin:

- 1) Parime dhe vlera që përputheshin me Islamin
- 2) Gjëra që feja i shihte si të lejuara, pra kishte hapësirë për to, siç mund të jenë – ta zëmë – stili i veshjes, ushqimeve, banimit e të ngjashme.

Islami, po kështu, ka ndryshuar edhe shumë bindje, ide dhe vlera të popujve paganë, si: adhurimin e idhujve, varrosjen e vajzave të gjalla, zhveshjen e grave etj. Islami miratoi disa parime dhe norma që gjendeshin në shoqërinë e mëhershme joislame, si: besimi në një Zot (arabët besonin se ekzistonte një Zot, por i përshkruanin shok), tavafi rreth Qabesë, Safaja dhe Merveja, ndërsa urtësia e kësaj, siç shpjegohet nga disa dijetarë, ka të bëjë me atë se devijimi nuk mund të jetë absolut; patjetër se popujt do të kenë diç të mirë. Por, e mira pëstillet me të keqen, e vërteta maskohet me të kotën dhe, në këto raste, intervenimi me ligj hyjnor për të kthyer gjendjen në natyrshmëri, ashtu siç duhet të jetë, është domosdoshmëri. Islami nuk i ka zhveshur popujt tërësisht nga traditat me të cilat kanë qenë të familjarizuar, ngase vlerat janë të shumta, ndërsa hapësira që përfshin 'e lejuara' është shumë e gjerë<sup>16</sup>, gjë kjo që flet për korrektësinë e Islamit, drejtësinë dhe transparencën e tij në raport me kulturat e tjera. Islami e ka ruajtur identitetin kombëtar nga humbja dhe shkrirja, sikurse që i ka ruajtur karakteristikat<sup>17</sup> etnike të popujve që e kanë pranuar Islamin. Metoda e spastrimit etnik nuk është pjesë e programit islam, sikurse që nuk është as vrasja

<sup>16</sup> Shatibi, Ebu Is'hak el-Garnati. (2004) *El-muvafekat fi usuli-sh-Sheriah*, f. 63-86.

<sup>17</sup> Kardavi, Jusuf. (1997) *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*, f. 9-54.

kolektive, zhveshja totale, ndryshimet topografike, në kuptimin e ndërrimit të emrave të njerëzve, vendeve dhe monumenteve historike. Islami nuk ka kërkuar t'i zhveshë popujt as nga vetitë dhe tiparet e trashëguara të tyre, siç kanë vepruar p.sh. të krishterët në Spanjë apo ortodoksët serbë në Bosnjë dhe Kosovë. Islami nuk ka vepruar kështu dhe ky nuk e ka synuar kurrë këtë, me përjashtim të rasteve kur disa tradita të caktuara kenë rënë ndesh me parimet dhe principet e tij të konfirmuara nga tekstet e qarta kur'anore dhe pejgamberike.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> El-Eshkar, Omer Sulejman. (2001) *Nahve thekafetin islamijetin esileh*, f. 36-40; Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, f. 19-31.

# Kapitulli II: BURIMET E INTELEKTUALIT MUSLIMAN BASHKËKOHOR

---

## II.1. KUR'ANI FISNIK

Kur'ani është të folurit e Zotit, që i është shpallur Muhammedit [alejhis salatu ves selam], leximi i të cilit është adhurim dhe i cili na është transmetuar sipas tevaturit [mënyrës më të saktë të mundshme], e i cili sfidon (qoftë edhe) me një ajet apo një sure që gjendet kopertinave të Mus'hafit.

Kur'ani është i vetmi që meriton të pasohet. Me shpalljen e tij janë anuluar të gjitha shpalljet e mëparshme. Allahu ka thënë:

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ<sup>ط</sup>

*"Feja e pranueshme tek All-llahu është Islami..."* (Ali Imran, 19)

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَسِرِينَ ﴿٨٥﴾

*"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit."* (Ali Imran, 85)

Ai është i vetmi që përmban udhëzimin e pastër hyjnor ndërsa kush kërkon udhëzim në libër tjetër, do ta humbasë Allahu.

فَإِنْ ءَامَنُوا بِمِثْلِ مَا ءَامَنْتُمْ بِهِ فَقَدْ أَهْتَدُوا<sup>ط</sup> وَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا هُمْ فِي شِقَاقٍ<sup>ط</sup> فَسَيَكْفِيكَهُمُ اللَّهُ<sup>ع</sup> وَهُوَ



*“Në qoftë se ata besuan ashtu siç besuat ju, ata vërtet kanë gjetur rrugën e drejtë, e nëse refuzojnë, atëherë ata janë kundërshtarë (opozitë), po ty (Muhammed) kundër tyre do të mjaftojë All-llahu. Ai është dëgjuesi, i dijsلمي.” (el-Bekare, 137)*

Prej urtësisë së Allahut ishte që Kur’ani të shpallej pjesë-pjesë, ndërsa përmbajtja e tij është udhëzim, mëshirë, Shërim, ligjësim, përgjegjësi. I është shpallë Muhammedit [alejhis salatu ves selam] që t’i udhëzojë me të njerëzit në rrugën e drejtë, që të zgjidhë problemet e tyre shoqërore. Ai nuk është i shkurtër që të mund të lexohet në një ndejë, apo të mësohet përmendësh për një ditë, gjë për të cilën edhe iu shpall Muhammedit [alejhis salatu ves selam] jo përnjëherë. Sigurisht kjo është bërë për urtësi të rëndësishme, si:

- 1) Themelimin e Ummetit sipas ligjit të gradualitetit, të cilit i nënshtrohet njëherësh e tërë jeta.
- 2) Për të lehtësuar nxënien përmendësh dhe kuptimin e domethëniesve të tij.
- 3) Përforcimi i besimtarëve para sfidave të ndryshme dhe të shumta
- 4) Për sqarimin e rasteve dhe rrethanave, për t’iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme, për të zbuluar sekretet e fshehura, etj.
- 5) Për të sqaruar se Kur’ani është i shpallur nga Allahu. Ajetet në të cilat qortohet Muhammedi [alejhis salatu ves selam] janë dëshmia më e mirë se Kur’ani është shpallje prej Allahut.<sup>19</sup>

Në fakt, edhe Kur’ani ka dhënë shpjegime pse është shpallë i tillë, pjesë-pjesë.

وَقُرْءَانًا فَرَقْنَاهُ لِتَقْرَأَهُ عَلَى النَّاسِ عَلَى مُكْثٍ وَنَزَّلْنَاهُ تَنْزِيلًا

*“Dhe (ta shpallëm) Kur'anin që Ne e ndamë pjesë - pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një.” (el-Isra, 106)*

<sup>19</sup> Zerkani, Abdu-l-Adhim. (1999) *Menahil el-urfan fi ulumi-l-Kur'an*. F. 60-75; Kattan, Mennaë. (1999) *Mebahith fi ulumi-l-Kur'an*.f. 105-118.

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْلَا نُزِّلَ عَلَيْهِ الْقُرْآنُ جُمْلَةً وَاحِدَةً كَذَلِكَ لِنُثَبِّتَ بِهِ فُؤَادَكَ وَرَتَّلْنَاهُ تَرْتِيلًا



*"E ata që nuk besuan thanë: "Përse të mos i ketë zbritur atij (Muhammedit) Kur'ani përnjëherë?" Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë) që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajeti (dalëngadalë)." (el-Furkan, 32)*

Kur'ani është shpallë pjesë-pjesë për të përforcuar zemrën e Muhammedit [alejhis salatu ves selam].

Ndërsa sa i përket temave që trajton Kur'ani, në radhë të parë, ai i referohet udhëzimit. Allahu ia shpalli Muhammedit [alejhis salatu ves selam] për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, nga pabesimi në besim. Në mësimet e tij është lumturia e të dy botëve. Kur'ani nuk është libër matematike, gjeografie, kimie, mjekësie a fizike, e dhe pse në të ka gjëra që iu përkasin këtyre shkencave të dobishme njerëzore dhe për të cilat Kur'ani e thërret njeriun të studiojë e përfitojë prej tyre. Allahu, duke përshkruar Kur'anin, thotë:

يَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَتْكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ

*"O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kur'ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët." (Junus, 57)*

ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

*"Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej All-llahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm." (el-Bekare, 2)*

هَذَا بَيَانٌ لِّلنَّاسِ وَهُدًى وَمَوْعِظَةٌ لِّلْمُتَّقِينَ

*"Ky (Kur'ani) është sqarim për njerëzit, është udhëzim dhe këshillë për të*

*devotshmit.*“ (Ali Imran, 138)

الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ ۗ الرَّحْمَنُ فَسَعَلٰ

بِهِ خَيْرًا ﴿١٣٨﴾

*“Ai krijoi qiejt e tokën dhe gjithçka që gjendet ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh, e pastaj mbizotëroi Arshin. Ai është Mëshiruesi. Për këtë pyete ndonjë shumë të dijshtëm.”* (el-Furkan, 59)

أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ ﴿١٤﴾

*“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë.”* (el-Mulk, 14)

Kur’ani është sfidues në stilin dhe formën e tij. Ai është sfidues në strukturën dhe lidhshmërinë, përsosmërinë dhe përputhjen ndërmjet pjesëve të tij. Ai është sfidues me ndikimin e tij, sikurse që sfidon me lajmërimet për të kaluarën dhe të ardhmen. Allahu ka thënë:

قُلْ لِّئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ

بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا ﴿٨٨﴾

*“Thuaj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njëri - tjetrin.”* (el-Isra, 88)

Obligimet tona karshi Kur’anit janë të shumta, por si më të rëndësishmet do të veçonim:

- 1) Leximi dhe këndimi i tij
- 2) Mësimi përmendsh i tij
- 3) Meditimi dhe mësimi i tij
- 4) Praktikimi dhe stolisja me moralin e tij

- 5) Thirrja në të
- 6) Dashuria për të, respektimi dhe madhërimi i tij.<sup>20</sup>

---

<sup>20</sup> Gazali, Muhammed. (1996) *Kejfe neteamel mea-l-Kur'an*, f. 30-56; Kardavi, Jusuf. (2001) *Kejfe neteamel mea-l-Kur'an*, f. 50-95; Gazali, Muhammed. (1995) *Es-Sunnetu en-nebevijeh bejne ehli-l-fikhi ve-l-hadith*, f. 5-35.

## II.2. SUNNETI PEJGAMBERIK

Termi ‘Sunnet’ vjen nga rrënja foljore ‘senne’ (سَنَّ), në shpjegimin e së cilës Ibni Farisi, në ‘Mu’xhemu mekajisi-l-lugah’, thotë se, gjuhësisht, ky term nënkupton rrjedhjen e një gjëje dhe largimin e saj me lehtësi. Thuhet: *senentu-l-mae ala vexhhi* – e kam derdhur ujë në fytyrën time! Ibn el-A’rabiu përmend edhe kuptime të tjera, si: traditë, lëmim (i hekurit), përkujdesje (për devetë), kryerje të diçkaje në mënyrë të mirë etj.<sup>21</sup>

Tradita e Muhammedit [alejhis salatu ves selam] – Sunneti – i përfshin edhe këto domethënie gjuhësore, për shkak se prej saj *rrjedhin* dispozita, me të cilat jeta njerëzore bëhet më *e mirë*. Nga këto domethënie gjuhësore përfitohet dija se Sunneti ka domethënie të përsëritjes, bërjes shprehi të një gjëje, vlerësimit – korrigjimit - ndreqjes, (thuhet) ‘senne Allahu sunneten’ – Allahu ka sqaruar një rrugë të drejtë (të duhur). Sunnetu-Allah (سُنَّةُ اللَّهِ) janë dispozitat e Allahut, urdhëresat dhe ndalesat. Në Kur’an, fjalët *Sunnet* dhe *Sunen* janë përmendur 27 herë dhe në të gjitha herët kanë ardhur me kuptimin e dispozitave të Allahut në funksion. Në këtë domethënie e fundit aludojnë këto ajete:

فَهَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا سُنَّتَ الْأَوَّلِينَ فَلَنْ نَحْدِلَ إِلَّا لِسُنَّتِ اللَّهِ تَبْدِيلًا ۗ وَلَنْ نَجِدَ لِسُنَّتِ اللَّهِ تَحْوِيلًا ﴿١٢٧﴾

“...Pra ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm gjurmët e të parëve, e në ligjin e All-llahut kurrë nuk do të hasësh devijim.” (Fatir, 43)

سُنَّةَ اللَّهِ الَّتِي قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلُ ۗ وَلَنْ نَجِدَ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا ﴿١٢٨﴾

“(ky është) Ligji i All-llahut që është i kahershëm edhe ndër të parët, në ligjin e All-llahut nuk do të gjesh ndryshime.” (el-Fet’hu, 23)

سُنَّتِ اللَّهِ الَّتِي قَدْ خَلَتْ فِي عِبَادِهِ ۗ وَخَسِرَ هُنَالِكَ الْكَافِرُونَ ﴿١٢٩﴾

<sup>21</sup> Ibni Zekerijja, Ebu el-Hasen Ahmed Faris. (1999) *Mu’xhemu mekajisi-l-lugah*. 3/61.

*“...Ky është ligj i All-llahut (i kahershëm) ndaj robërve të Tij dhe aty, në atë çast, pësuan disfatë jobesimtarët.” (Gafir, 85)*

Ndërsa në terminologjinë fetare, Sunneti nënkupton fjalët, veprat, miratimet dhe vetitë morale dhe fizike të të Dërguarit të Allahut, Muhammedit [alejhis salatu ves selam]. Në fakt, ky është një definicion i përgjithshëm, përndryshe mund të gjesh definicione, dallimi tek të cilat nuk shprehet për shkak të mospajtimit përmbajtjesor a filozofik, por për shkak të definimit nga një këndvështrim i caktuar. Hadithologët e kanë vështruar Sunnetin nga aspekti i pasimit të tij, ndërsa usulistët e kanë shikuar nga cilësia e të qenit ligjërues dhe sqarues nga Allahu i Madhëruar, kështu që kanë marrë prej tij atë që iu është dashur si argument për ndonjë dispozitë fetare që ka të bëjë me lejimin apo ndalimin...<sup>22</sup>

Sunneti, në raport me Kur'anin Fisnik, mund të jetë:

- 1) Të sjellë atë që përputhet me mësimet e Kur'anit, si: urdhri për namaz etj.
- 2) Të ligjësojë atë që parimisht gjendet në Kur'an, si: ndalimi i ngrënies së mishit të gomarit shtëpiak dhe kafshëve të egra me dhëmbë ushqyes. Baza e kësaj ndalese është në Kur'an:

وَأُحِلُّ لَهُمُ الطَّيِّبَاتِ وَتُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ الْخَبَائِثَ

*“...u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet...” (el-A'rafë, 157)*

- 3) Ligjësim të dispozitave të pavarura, që nuk janë përmendur fare në Kur'an, si: ndalimi i bashkimit në një kurorë të gruas me hallën apo me tezen e saj.
- 4) Sqarim të asaj që përgjithësisht është përmendur në Kur'an, sqarim të ndonjë gjëje të paqartë, specifikim të ndonjë gjëje të përgjithshme, kushtëzim të ndonjë gjëje të pakushtëzuar. Allahu ka thënë:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ ﴿١١﴾

*“...Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur*

<sup>22</sup> Për më shumë shih: *El-ihkam fi usuli el-ahkam* të Amidiut, f. 1/129; *El-mustasfa* të Imam Gazaliut, f. 1/129; *El-ihkam fi usuli el-ahkam* të Ibni Hazmit, f. 1/93; *Hashijetu nesemati el-es'har* të Ibni Abidinit, f. 176 dhe *El-muwaafekat* të Shatibiut, 3/4.

*atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin).“ (en-Nahl, 44)*

P.sh. në Kur'an, namazi është përmendur vetëm si obligim, ndërsa detajet për të janë dhënë në Sunnet<sup>23</sup>.

Dijetarët janë unanimitas sa i përket autoritetit të Sunnetit për të argumentuar me të dhe për të qenë burim i dispozitave fetare. Allahu ka thënë:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿٧٩﴾

*“...Çka t'ju japë Pejgamberi, atë merreni, e çka t'ju ndalojë, përmbajuni dhe kini frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër.“ (el-Hashr, 7)*

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا لِمُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُّبِينًا ﴿٦٧﴾

*“Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.“ (el-Ahzab, 36)*

Muslimanët i përfitojnë vlerat, qëndrimet, zakonet, ligjet, karakteristikat dhe tiparet e personalitetit të tyre nga Sunneti. Sunneti ka lënë gjurmë të pashlyera, jo vetëm në botën islame. Perëndimorët kanë pranuar se personaliteti i Muhammedit [alejhissalatu ves selam] është më i shquari në të gjithë historinë njerëzore, madje në librat e tyre e kanë vënë në krye të të gjithë personaliteteve botërore<sup>24</sup>. Allahu ka thënë:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ ﴿٤١﴾

*“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!“ (el-Kalem, 4)*

<sup>23</sup> Fajiz, Habis. *Eth-thekafetu el-islamijeh II*, f. 135-141.

<sup>24</sup> Shih librin '100 personalitetet më me ndikim' të Majkëll Hartit.

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا ﴿٢١﴾

*"Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun."* (el-Ahzab, 21)

Nga ajetet e mësipërme kuptojmë faktin se Allahu e ka lëvduar të Dërguarin e Tij dhe e ka vlerësuar për tiparet dhe cilësitë e mira që ka, gjë që do t'i mjaftonte Umnetit Islam për t'u nderuar edhe sikur të mos kishte asgjë tjetër me të cilën të nderohej.

Ndërsa sa i përket rëndësisë së Sunnetit për muslimanin intelektual, atëherë ajo do të mund të përmbledhet në pikat në vijim:

Sunneti reflekton një korpus të madh vlerash dhe virtytesh, në rrethana paqeje dhe lufte, dhe këtë pavarësisht se a bëhet fjalë për individin, shoqërinë apo shtetin. Muhammedi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:

الدين النصيحة“

*Feja është këshillë!...”*<sup>25</sup>

من رأى منكم منكراً فليغيره بيده، فإن لم يستطع فبلسانه“

*Kushdo që prej jush sheh një të keqe, le ta ndalë atë me dorë, e nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij...”* (Muslimi)

من أحدث في أمرنا ما ليس منه فهو رد“

*Kush shpik diç në këtë çështjen tonë, e që nuk ka të bëjë me të, vepra do t'i refuzohet!”*<sup>26</sup>

Sunneti sqaron mënyrat dhe rrugët e njohurive të sakta, si edhe kërkon argumentimin e gjërave. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:

لا عدوى ولا طيرة ولا غول“

<sup>25</sup> Transmetojnë Imam Ahmedi në Musned, nr. 2297, dhe Tirmidhiu në Sunen, nr. 1926.

<sup>26</sup> Transmetim unanim nga Buhariu (nr.2697) dhe Muslimi (1718).



*Nuk ka infektim, as pesimizëm dhe as gogol!”<sup>27</sup>*

Domethënia e hadithit është se infektimi nuk është se do të ndodhë patjetër. Në fakt ai nuk ndodh veçse me caktimin e Allahut. Pesimizmi, po kështu, është kotësi. Arabët, në periudhën para Islamit, e kishin zakon që kur niseshin në ndonjë udhëtim lëshonin një pëllumb. Në rast se ai fluturonte në të djathtë, ata bëheshin optimistë, ndryshe binin në pesimizëm. E këtillë mbetet edhe bindja në trillimet dhe besëtytnitë se kinse ka gogol, me të cilin ata i frikësonin fëmijët për të fjetur.

Sunneti është i rëndësishëm dhe për faktin se e edukon besimtarin me moral praktik dhe edukativ. P.sh. Muhammedi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:

ليس منا من لم يرحم صغيرنا ويعرف شرف كبيرنا“

*Nuk është prej nesh ai që nuk i mëshiron të vegjlit tanë dhe nuk i nderon pleqtë!”*

لا يدخل الجنة من كان في قلبه مثقال ذرة من الكبر“

*Nuk do të hyjë në Xhennet ai në zemrën e të cilit ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie!”<sup>28</sup>*

Para se ta përmbyll këtë pikë, gjithsesi se do të ndalem pak edhe tek kur'anistët, lëvizje kjo që është përhapur në disa vende islame dhe e cila, ndonëse pretendon referimin në Kur'an, nuk ka të bëjë fare me të. Më ka rënë të dëgjoj disa prej tyre nga afër, respektivisht të dëgjoj ligjëratat e tyre të publikuara në internet, por nuk kam parë tjetër veçse një injorancë të thellë. Kam parë madje se ata gabojnë edhe në rregullat më të thjeshta të leximit të Kur'anit. Turp për ta që mohojnë rëndësinë e Sunnetit! Sikur të më lejonte natyra e punimit, gjithsesi do të flisja më shumë për ta, por me kaq po e mbyll, duke përsëritur edhe një herë rrezikun e madh që vjen prej tyre, për shkak se me një injorancë të thellë e mohojnë rëndësinë e Sunnetit!<sup>29</sup>

<sup>27</sup> Transmetojnë Imam Ahmedin në Musned, 1/269, dhe Ibni Maxhe në Sunen, nr. 3539.

<sup>28</sup> Transmetojnë Imam Muslimi në Sahihun e tij, nr. 91, Imam Ahmedin në Musned, 1/312 dhe Ebu Davudi në Sunen, nr. 4091.

<sup>29</sup> Ja disa nga ligjëratat e tyre: [:http://www.youtube.com/watch?v=JrzykDfptig](http://www.youtube.com/watch?v=JrzykDfptig)  
<http://www.youtube.com/watch?v=oK2bnZl2V0c&feature=relmfu>

### II.3. MENDIMI DHE TRASHËGIMIA ISLAME

Mendimi islam është prej veçorive më të spikatura të intelektualit musliman bashkëkohor. Thënia ‘unë mendoj, pra unë ekzistoj’ mbase është e qëlluar. Jeta njerëzore, si të thuash, është një lloj bashkëveprimi ndërmjet mendjes dhe pranisë (ekzistimit). Pas çdo lëvizje a veprimi qëndron një ide. Edhe Kultura Islame ka idetë dhe mendimtarët e saj. Në fakt, ky sfond i saj prej të medituari dhe përsiaturit nuk është tjetër vetëm se reflektim i veçorisë tjetër të saj, asaj hyjnore. Kur’ani na fton për meditim dhe përsiatje rreth shumë gjërave, dhe këtë për shkak të rëndësisë që ka meditimi në formimin e personalitetit të intelektualit musliman në çdo kohë dhe vend.

Mendimi dhe të menduarit (përsiatja, meditimi, studimi, hulumtimi) kanë këto veçori:

- 1) Janë obligim islam. Me ringjalljen e këtij obligimi, ringjallet edhe Ummeti nga agonia e tij. Allahu ka thënë:

﴿ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَفَكَّرُونَ ﴾

*“...Kështu ua sqaron All-llahu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq).” (el-Bekare, 219)*

﴿ قُلْ سِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُجْرِمِينَ ﴾

*“Thuaj: "Udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i kundërshtarëve!” (en-Neml, 69)*

﴿ وَسَخَّرَ لَكُمْ مَّا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا مِّنْهُ ۗ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ

﴿ يَتَفَكَّرُونَ ﴾

*“Dhe për ju nënshtroi gjithë ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë, njëmend për njerëzit që mendojnë thellë, në to ekzistojnë argumente.” (el-Xhathije, 13)*

﴿ وَلَقَدْ تَرَكْنَا مِنْهَا آيَةً بَيِّنَةً لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴾

*“E nga ai vend Ne kemi lënë gjurmë të qartë për një popull që mendon.”* (el-Ankebut, 35)

وَهُوَ الَّذِي أَنشَأَكُمْ مِّن نَّفْسٍ وَاحِدَةٍ فَمُسْتَقَرٌّ وَمُسْتَوْدَعٌ ۗ قَدْ فَصَّلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَفْقَهُونَ



*“Ai është që ju krijoi (filloi) prej një njeriu; aty (mbi tokë) jetoni (qëndroni) dhe nën të do të pushoni. Ne ia sqaruam argumentet një populli që di të kuptojë.”* (el-En’amë, 98)

- 2) Të medituarit është formë dhe mjet i kuptimit të fesë dhe nxjerrjes së dispozitave fetare, sidomos në rastet kur këto të fundit duhet të përfitohen indirekt nga kuptimi dhe domethënia e teksteve. Allahu ka thënë:

وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ الْأَمْنِ أَوْ الْخَوْفِ أَدَّعُوا بِهِ ۗ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَىٰ أُولِي الْأَمْرِ  
مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنبِطُونَهُ مِنْهُمْ ۗ وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَاتَّبَعْتُمُ الشَّيْطَانَ إِلَّا



*“Madje kur u vjen atyre (munafikëve) ndonjë lajm qetësues (kur fitojnë muslimanët) ose shqetësues (kur dështojnë), ata e përhapin atë, e sikur t'ia linin atë (përhapjen lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do dinin të nxirrnin përfundime (se si do të duhej shpallur). Por sikur të mos ishte dhuntia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, atëherë ju, pos një pakice, do të ndiqnit rrugën e djallit.”* (en-Nisa, 83)

Kjo është ajo që ne e quajmë *ixhtihad*, të cilit feja ia ka ngarkuar barrën e gjetjes së zgjidhjeve për shumë ngjarje dhe ndodhi<sup>30</sup>.

Intelektuali musliman bashkëkohor, duhet të disponojë medoemos njohuri dhe dije për historinë islame, për biografinë e katër Hulefai-Rrashidinëve (katër

<sup>30</sup> Mursafi, Seid. (2005) *Eth-thekafetu el-islamijeh ve etheruha fi tekvini-sh-shahsijjeti-l-islamijeh*, f. 78-84; Muslim, Mustafa. (2004) *Eth-thekafetu el-islamijeh: ta'rifuha, mesadiruha, mexhalatuhu, tehaddijatuha*, f. 30; Seid, Hemmam & Halidi, Salah. (2002) *El-voxhiz fi-th-thekafeti-l-islamijeh*, f. 45; Ulvan, Abdullah Nasih. (2002) *Esh-shebab el-muslim fi muvaxheheti-t-tehaddijat*, f. 221-275; Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, f. 35-53; Kardavi, Jusuf. (2010) *Thekafetu-d-daijeh*, f. 102-108.

prijësve të drejtë pas Muhammedit [alejhis salatu ves selam]). Po kështu, intelektual musliman bashkëkohor duhet të disponojë njohuri të bollshme rreth: aktualitetit të Ummetit Islam, të vërtetës përkitazi me forcat kundër Islamit, realitetin e feve moderne, realitetin e drejtimeve politike bashkëkohore, të vërtetën mbi lëvizjet moderne islame, të vërtetën mbi rrymat me qëndrim negativ ndaj Islamit, të vërtetën për fraksionet me ngjyrë islame, njohjen me rrethin dhe ambientin etj.<sup>31</sup>

Se çfarë duhet të posedojë, të dijë dhe me çka duhet të dallohet intelektual musliman modern, do të mësojmë gjerësisht edhe në vazhdim, me lejen e Allahut!

---

<sup>31</sup> Kardavi, Jusuf. (2010) *Thekafetu-d-daijeh*, f. 141-145; Izetbegović, Alija. (1994) *El-Islamu bejne-sherki ve-l-garbi*, f. 105-110; Salah Abdul Fettah. (2002) *Amerika min ed-dahil bi-mindhari Sejjid Kutb*, f. 97-123.

# Kapitulli III:

## BAZAT DHE PRINCIPET E KULTURËS SË MUSLIMANIT BASHKËKOHOR

---

Muslimani dhe thirrësi bashkëkohor ka nevojë për gjashtë lloj kulturash:

- 1) Kulturë fetare,
- 2) Kulturë gjuhësore dhe letrare,
- 3) Kulturë historike,
- 4) Kulturë shoqërore,
- 5) Kulturë shkencore dhe
- 6) Kulturë të realitetit.<sup>32</sup>

Dr. Jusuf Kardavi, duke folur për rëndësinë e kulturës, thotë: "...popujt, sigurisht, dallojnë shumë në kulturë nga njëri-tjetri. Ka prej tyre, kultura e të cilëve është e drejtuar nga shpirti (spiritualiteti), të tjerë kultura e të cilëve është e drejtuar nga mendja (logjika) e disa të tjerë kultura e të cilëve është e drejtuar nga materializmi. Ka popuj kultura e të cilëve është e lidhur me tokën, sikur që ka të tjerë, kultura e të cilëve është e lidhur me qiellin. Prej tyre ka që e njohin Allahun për Krijues, por nuk e adhurojnë; të tjerë që e adhurojnë por nuk e aplikojnë ligjin e Tij në jetën e përditshme, e ka prej tyre që i kanë bashkuar të gjitha këto elemente: nuk kërkojnë zot pos Allahut, nuk adhurojnë askënd përveç Tij, si dhe nuk marrin Ligjvënës askënd pos Tij."<sup>33</sup>

Edhe ne, me këtë rast, duam të konfirmojmë se kultura jonë, këtu kam për qëllim kulturën e Ummetit në tërësi, është kulturë e veçantë, por, megjithëkëtë, ende ngrihet pyetja se ç'identitet ka kultura jonë: a është arabe, shqiptare, turke, melaje? - duke nënkuptuar, në një farë forme, se konfirmimi i njërit identitet mbron identitetin tjetër. Ky botëkuptimi i fundit mbase është i gabuar, ngase gjuha arabe është gjuhë e Islamit, gjuhë e Kur'anit dhe Sunnetit, është gjuhë

---

<sup>32</sup> Kardavi, Jusuf. (2010) *Thekafetu-d-daijeh*, f. 93-113.

<sup>33</sup> Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, f. 19.

ndërkombëtare tek dijetarët muslimanë. Islami ishte ai që i nxori arabët nga errësira në dritë dhe i bëri të denjë për të qenë kujdestarë të njerëzimit. Dr. Kardavi vazhdon me sqarimet e tij: *“...dhe bazuar në këtë, nuk shohim ndonjë kundërthënie ndërmjet arabizmit dhe islamizmit, sikurse që nuk gjejmë ndonjë pengesë që kulturën tonë ta thërrasim njëkohësisht kulturë arabe islame. Këtë nuk e themi si mirësjellje për Islamin dhe as si lajkatim për arabizmin; kjo është një e vërtetë, për të cilën flasim argumentet dhe faktet...”*<sup>34</sup>

Po kështu, mund të themi se nuk ka kundërthënie ndërmjet të qenit të kulturës sonë shqiptare, turke, boshnjake, melaje dhe islame, sikur që nuk gjejmë ndonjë pengesë që ta përshkruajmë kulturën tonë si arabe nga një aspekt, dhe islame nga aspekti tjetër, shqiptare nga një aspekt, dhe islame nga aspekti tjetër...

---

<sup>34</sup> Ibid.

### III.1. BAZAT E KULTURËS ISLAME

#### III.1.1 Feja

Feja, çfarëdo qoftë, ka ndikim në kulturën e njerëzve, por kur jemi tek Islami, ai njëherësh është themelues i kësaj kulture, ruajtës dhe ripërtëritës i saj. Islami i ka lidhur pjesët e kulturës me nyje besimi, shpërblimi dhe llogarie. Vlerat e kulturës islame janë vlera islame dhe humane, si: e vërteta, drejtësia, sinqeriteti, dëlirësia, besimi, morali, bashkëpunimi, nderimi, respektimi i fqinjit, mbajtja e lidhjeve familjare etj. Allahu ka thënë:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٠٢﴾

*"Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve." (el-En'amë, 162)*

قُلِ اللَّهُ أَعْبُدُ مُخْلِصًا لَهُ دِينِي ﴿١٠٣﴾

*"Thuaj: "Vetëm All-llahun e adhuroj, sinqerisht ndaj Tij e bëj adhurimin tim." (ez-Zumer, 14)*

وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ حَتَّىٰ يَبْلُغَ أَشُدَّهُ ۗ وَأَوْفُوا بِالْكَيْلِ وَالْمِيزَانَ بِالْقِسْطِ ۗ لَا تَكْلِفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا ۗ وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدُوا ۗ وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ ۗ وَبِعَهْدِ اللَّهِ أَوْفُوا ۗ ذَٰلِكُمْ وَصَّيْنَاكُمْ

بِهِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿١٠٤﴾

*"Mos iu afro ni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë, (mund t'i afroheni) vetëm në mënyrë më të mirë, zbatoni me drejtësi masën dhe peshojën. Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij. Kur të flitni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse është çështja për (kundër) të afërmit, dhe zotimin e dhënë All-llahut plotësojeni. Këto janë me çka Ai ju porosit kështu që të*

përkujtoni.“ (el-En'amë, 152)

وَالَّذِينَ تَبَوَّءُوا الدَّارَ وَالْإِيمَانَ مِنْ قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِمَّا أُوتُوا وَيُؤْتُونَ عَلَى أَنْفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ وَمَنْ يُوقِ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٥٢﴾

*“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.” (el-Hashr, 9)*

### III.1.2. Historia Islame

Historia është shumë e rëndësishme për intelektualin musliman. Qëllimi i studimit të saj është marrja mësim nga përvojat e të tjerëve si dhe studimi i shkaqeve që çuan në ngritjen por edhe në rënien e tyre. Allahu ka thënë:

لَقَدْ كَانَتْ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولِي الْأَلْبَابِ ۗ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَٰكِن تَصَدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿١١١﴾

*“Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësim e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kur'ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjtë) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111)*

Historia ka ndikimin e vet. Ajo është përplot lavdi, por edhe kujtime të hidhura. Kjo për shkak të sjelljeve të njerëzve dhe llogaritjeve të gabuara të tyre. Edhe historia jonë, po ashtu, duhet të lexohet me të dy aspektet e saj.<sup>35</sup> Ajo që në fakt dua ta nënvizoj këtu dhe që e shoh si shumë të rëndësishme dhe si kriter për t'u

<sup>35</sup> Xhunejdi, Abdullah Shakir. (2004) *Muhadaratun fi-th-thekafeti-l-islamijeh*, f. 11-32.



përvetësuar është që të mos e marrim historinë tonë të bujshme si mjet për të justifikuar të metat dhe neglizhencën tonë sot. “Historia është mbreti i kohës, në të cilën ka lindur, e që nuk trashëgon lavdinë dhe as dështimet. Ajo që trashëgon është vetëm mësimarrja.”<sup>36</sup>

### III.1.3. Gjuha arabe

Gjuhët patjetër se kanë një rol të madh në jetët e njerëzve. Edhe në raport me muslimanin, gjuha ka rëndësinë e vet, sidomos ajo arabe, pasi që me të ruhet feja. Ndoshta më së miri është të thuhet se ruajtja ndërmjet fesë dhe gjuhës arabe është reciproke, pasi që po të mos ishte Kur’ani dhe Sunneti, gjuha arabe do të shkrihej në ndonjë gjuhë tjetër. Falë ndikimit të fuqishëm të shprehjeve fetare, të cilat nuk ndryshojnë me ndryshimin e kohës, gjuha arabe mbeti dhe vazhdon të jetë e fuqishme. Kur’ani aludon në këtë kur e përshkruan veten:

قُرْآنًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عِوَجٍ لَّعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٢٨﴾

*“Duke qenë Kur’ani arabisht që nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar.”* (ez-Zumer, 28)

Fakti se Kur’ani u shpall në gjuhën arabe, në këtë gjuhë që nuk shtrembërohet, ndryshe do të mund të kuptohej (sipas konceptit të merhum el-muhalefe) se gjuhët e tjera kanë mangësi. Këtë mund ta vëresh qartë në gjuhët moderne. P.sh. në anglishte, gjen se si një shkronjë shqiptohet në forma të ndryshme dhe jo të qëndrueshme, si shkronjat ‘i’, ‘e’, të cilat në raste të shumta kanë shqiptime të caktuara në fillim të fjalës, tjetër në mes të saj dhe krejtësisht tjetër në fund të saj. Ai që nuk ka njohuri në gjuhën angleze, do të hasë në vështirësi të mëdha për shkak të kësaj natyre të shqiptimit në të shprehur dhe konverzacion. Këtë gjë nuk mund ta hasësh në shkronjat e gjuhës arabe. Prof. Talib Abdu-Rrahman Abdul Xhebbbar thotë: Është evidente dhe e qartë se në gjuhën angleze një shqiptim (zë) shkruhet në më shumë se një formë, ndërsa shqiptimet (zërat)

<sup>36</sup> Buti, Muhammed Seid Ramadan. (1997) *Kubra el-jekiniyyat el-keunijeh*, f. 65.

dallojnë ndërmjet vete për nga mënyrat që mund të shkruhen. P.sh. shqiptimi (zëri) 'th' në anglisht nuk shkruhet veçse në këtë formë, ndërsa një shqiptim (zë) tjetër, ta zëmë 'schwa' shkruhet deri në 28 mënyra. Sigurisht, për shkak të mundësisë së kufizuar, shpjegimin do ta përqendrojmë vetëm tek një nga shembujt më të këqij të shqiptimit në gjuhën angleze, për shkak të formave të ndryshme që merr në të shkruar. Më konkretisht, do të marrim shembull 'sh'- në, një zë të mesëm, i cili shkruhet në 15 forma, si: 'sh, c, ch, s, ti, ss, sc, chs, sci, ssi, si, ci, sch, se, x.'

E keqja është se nuk ka ndonjë rregull gramatikor në anglishte që do ta orientonte lexuesin në zgjedhjen e njërit apo tjetrit opsion. E tërë puna ka të bëjë me vetë fjalën. Çështja bëhet edhe më komplekse atëherë kur mësojmë se këto alternativa ripërdoren një apo më shumë herë për të shprehur zëra që nuk ka të bëjnë fare me 'sh'-në. P.sh. opsioni 'x', i pesëmbëdhjeti në radhë i përmendur për shenjën 'sh', përdoret për 'sh'-në në fjalën 'luxury', por përdoret edhe për zëra tjerë, si:

- 1) 'ks' - p.sh. fjala 'box'
- 2) 'kz' - p.sh. në fjalën 'exaggerate'
- 3) 'z' - p.sh. në fjalën 'xylophone'
- 4) apo nuk lexohet fare, si në fjalën 'faux pas'<sup>37</sup>.

Ndërsa gjuha arabe dallon nga gjuhët e tjera për veçori dhe karakteristika, si:

- 1) Fleksibiliteti dhe aftësia në nxjerrjen (derivim) e fjalëve
- 2) Aftësia dhe përshtatshmëria për ripërtëritje
- 3) Aftësia për t'i bërë ballë kohës dhe bashkëveprimi me nocionet e reja shkencore.<sup>38</sup>

---

<sup>37</sup> *Nevakis fi-l-kitabetejni el-ferensijjeti ve-l-inkilizijeeh*. Katar: Ministria e vakëfit, : [http://www.islamweb.net/newlibrary/display\\_umma.php?lang=&BabId=7&ChapterId=7&BookId=269&CatId=201&startno](http://www.islamweb.net/newlibrary/display_umma.php?lang=&BabId=7&ChapterId=7&BookId=269&CatId=201&startno)

<sup>38</sup> Ulvan, Abdullah Nasih. (2002) *Esh-shebab el-muslim fi muvaxheheti-t-tehaddijat*, f. 125-160.

Ndërsa fakti se intelektual musliman duhet ta mësojë gjuhën arabe është diç që nuk diskutohet. Këtë të vërtetë e kuptuan rrënjësisht disa intelektualë perëndimorë, që e pranuan Islamin kohëve të fundit, si: Rozhe Garodi, Weiss Muhammad Asad Leopold, i cili njëherësh ka bërë edhe përkthimin e domethënies të Kur'anit Fisnik. Kjo për arsye se feja është shpallur në gjuhën e arabëve dhe sipas botëkuptimeve të tyre. Rrëfëhet se Imam Shafiu ka thënë: Allahu i Madhëruar iu është drejtuar arabëve me gjuhën e tyre dhe me kuptimet me të cilat ata janë familjarizuar. Shkurt, ata që duan ta kuptojnë Kur'anin, më parë duhet ta kenë mësuar gjuhën arabe<sup>39</sup>.

Kur'ani është edhe më shumë i rëndësishëm për arabishten se që arabishtja është për të. Atij i takojnë meritat e ruajtjes së kësaj gjuhe nga shtrembërimet dhe devijimet nga një gjuhë letrare në një dialekt që sot ndoshta nuk do të kishte asnjë vlerë. Fati i saj do të ishte i ngjashëm me atë të dialektit kopt në Egjipt, atij nipt në Irak, dialektit aramit në Sham etj. Në komentimin e ajetit:

قُرْءَانًا عَرَبِيًّا غَيْرِ ذِي عِوَجٍ لَّعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٢٨﴾

*“Duke qenë Kur'ani arabisht që nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar.”* (ez-Zumer, 28)

- ...Hoxha i nderuar, Shenkiti, ka thënë: Për shpjegimin e kësaj kemi përmendur argumentet (ajetet) në fillim të komentimit të kaptinës el-Kehf, respektivisht në komentimin e ajeteve:

أَلْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا ﴿١﴾

*“Falënderimi i takon vetëm All-llahut që ia shpalli robit të vet Librin dhe në të nuk lejoi ndonjë kundërthënie.”* (el-Kehf, 1)

<sup>39</sup> Shatibi, Ebu Is'hak el-Garnati. (2004) *El-muvafekat fi usuli-sh-Sheriah*, f. 102-105.

Kjo nuk i ndodh Kur'anit – vazhdon shpjegimin Shejh Shenkiti – për shkak se ai është shpallur në gjuhën arabe, siç ka thënë Allahu:

وَلَقَدْ نَعَلْنَا أَنَّهُمْ يَقُولُونَ إِنَّمَا يُعَلِّمُهُ بَشَرٌ لِّسَانُ الَّذِي يُلْحِدُونَ إِلَيْهِ أَعْجَمِيٌّ وَهَذَا لِسَانٌ

عَرَبِيٌّ مُّبِينٌ ﴿١٦٣﴾

*Ne dimë shumë mirë se ata thonë: "Atë (Muhammedin) është nga e mëson një njeri!" Mirëpo, gjuha e atij nga i cili anojnë (supozojnë) ata është joarabe (e paqartë), e kjo (e Kur'anit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë." (en-Nahl, 103)*

نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِن كُنْتَ مِنْ قَبْلِهِ لَمِنَ

الْغَافِلِينَ ﴿٣﴾

*"Ne me të shpallur të këtij Kur'ani po të rrëfejme ty (Muhammed) më të bukurin rrëfim, edhe pse para tij ishe nga të painformuarit." (Jusuf, 3)*

وَكَذَلِكَ أَنزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا وَصَرَّفْنَا فِيهِ مِنَ الْوَعِيدِ لَعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ أَوْ يُحَدِّثُ بِهِمْ ذِكْرًا ﴿١١٣﴾

*"Kështu Ne e shpallëm këtë Kur'an arabisht dhe përsëritëm në të vërejtjet, në mënyrë që ata të ruhen ose ai (Kur'ani) t'u sjellë atyre përvojë mësimi." (Taha, 113)*

وَلَوْ جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا عَجَمِيًّا لَقَالُوا لَوْلَا فُصِّلَتْ آيَاتُهُ ۗ أَأَعْجَمِيٌّ وَعَرَبِيٌّ ۗ قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ آمَنُوا

هُدًى وَشِفَاءً ۗ وَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ فِي آذَانِهِمْ وَقْرٌ وَهُوَ عَلَيْهِمْ عَمًى ۗ أُولَٰئِكَ يُنَادَوْنَ مِن

مَكَانٍ بَعِيدٍ ﴿١٤﴾

*"Sikur Ne ta bënim Kur'anin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: "Përse nuk janë ajetet e tij të kuptueshme (të shkoqitura), a është ai (Kur'ani) në gjuhë të huaj,*

kurse ai (pejgamberi) është arab?" Thuaj: "Ai është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë, në veshët e tyre kanë shurdhim, dhe ai për ta është verbërim. Të tillët janë sikurse thirren prej një vendi të largët e nuk dëgjojnë".  
(Fussilet, 44)

وَإِنَّهُ لَتَنْزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٩٣﴾ نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ ﴿١٩٤﴾ عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ ﴿١٩٥﴾  
بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ ﴿١٩٦﴾

"E edhe ai (Kur'ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. 193. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). 194. (E solli) Në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber). 195. (Të shpallëm) Me gjuhë të kulluar arabe."  
(esh-Shuara, 192-195)

وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لِتُنذِرَ أُمَّ الْقُرَىٰ وَمَنْ حَوْلَهَا وَتُنذِرَ يَوْمَ الْجُمُعِ لَا رَبَّ فِيهِ فَرِيقٌ  
فِي الْجَنَّةِ وَفَرِيقٌ فِي السَّعِيرِ ﴿١٩٦﴾

"Prandaj, Ne të shpallëm ty Kur'anin arabisht që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ata përreth saj, dhe t'u tërheqësh vërejtjen për ditën e tubimit (kiametit), për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në xhenet, kurse një grup për në zjarr." (esh-Shura, 7)

وَكَذَلِكَ أَنْزَلْنَاهُ حُكْمًا عَرَبِيًّا وَلَئِنْ اتَّبَعْتَ أَهْوَاءَهُمْ بَعْدَ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ مَا لَكَ مِنَ اللَّهِ مِنْ وَاقٍ ﴿١٩٧﴾

"Dhe ashtu, Ne e shpallëm atë (Kur'anin) kushtetutë në arabishte. E nëse ti pasi të kanë ardhur argumente të qarta shkon pas dëshirave të tyre, ti nuk ke prej Allahut as ndihmë as mbrojtje." (err-Rr'ad, 37)

Këto dhe ajete të ngjashme flasin për vlerën e gjuhës arabe dhe madhësinë e saj, gjëra këto që vetëm një kryeneç mund t'i mohojë <sup>40</sup>.

Kur'ani, në raport me gjuhën arabe, ka merita edhe për pasurimin e saj me fjalë dhe shprehje të përdorura (panjohura) më parë. Po kështu, përhapja e saj në botë është bërë nëpërmjet përhapjes së Islamit, ngase adhurimi nuk lejohet ndryshe veçse me lexim në gjuhën arabe. Kjo i ka dhënë gjuhës arabe një lloj sfondi të shenjtë, madje nga selefitë (të parët) janë transmetuar thënie me këtë kuptim, si ajo që i atribuohet Omer Ibn Hattabit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] dhe Imam Shafiut [Allahu e mëshiroftë!] se “po patët mundësi, mos komunikoni me gjuhë tjetër përveç asaj arabe.”

Ndonëse janë përpjekur shumë, armiqtë e fesë kanë dështuar që gjuhën letrare arabe ta shtrembërojnë apo të paktën t'ia humbin këtë ndikim të madh që ka. <sup>41</sup>

### III.2. KARAKTERISTIKAT E KULTURËS ISLAME

Kultura perëndimore shquhet për plotësimin e dëshirave të kësaj bote. Karakteristikë e kulturës arabe paraislame ishte mbizotërimi i xhinëve dhe astrologëve mbi jetën. Karakteristikë e kulturës greke dhe romake ishte dhënia pas epsheve dhe kënaqësive, ndërsa në Kulturën Islame, puna qëndron krejtësisht më ndryshe. Karakteristikat kryesore të Kulturës Islame janë:

- 1) Konstruktimi i mendjes dhe vetëdijes së shëndoshë.
- 2) Kultivimi i zemrës dhe shpirtit të pastër.
- 3) Mbjellja e besimit të pastër të bazuar në Njëshmëri.
- 4) Dallimi dhe veçimi i Ummetit me moralin, sjelljet dhe traditat e saj.
- 5) Krijimi i një rendi dhe rregulli në tokë.
- 6) Bashkëveprimi me jetën dhe qëndrueshmëria përballë sfidave.
- 7) Përkujtimi i sahabëve [Allahu qoftë i kënaqur me ta!] dhe trajtimi që i bën Kur'anit, si dhe respekti dhe pasimi që i bën të Dërguarit të Allahut [alejhissalatu ves selam].

Si dëshmi për këto karakteristika do të mund t'iu referoheshim disa ajeteve

---

<sup>40</sup> Shenkiti, Muhammed Muhtar. (2007) *Tefsiru advai-l-bejan*. 6/361.

<sup>41</sup> Salih Hindi dhe të tjerë. (2000) *Eth-thekafetu el-islamijeh*, f. 83-85.

kur'anore, si:

الَّذِينَ إِن مَّكَّنْتَهُمْ فِي الْأَرْضِ أَقَامُوا الصَّلَاةَ وَءَاتَوْا الزَّكَاةَ وَأَمَرُوا بِالْمَعْرُوفِ وَنَهَوْا عَنِ الْمُنْكَرِ ۗ وَاللَّهُ  
عَلِيمٌ بِالْأُمُورِ ﴿٤١﴾

*“(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.” (el-Haxh-xh, 41)*

وَلَقَدْ كَتَبْنَا فِي الزَّبُورِ مِن بَعْدِ الذِّكْرِ أَنَّ الْأَرْضَ يَرِثُهَا عِبَادِيَ الصَّالِحُونَ ﴿١٠١﴾

*“Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Levhi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.” (el-Enbija, 105)*

﴿ وَمَا مِن دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا وَيَعْلَمُ مُسْتَقَرَّهَا وَمُسْتَوْدَعَهَا ۗ كُلٌّ فِي كِتَابٍ مُّبِينٍ ﴿١٠١﴾

*“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj, Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e njohur (Levhi Mahfudh).” (Hud, 6)*

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ ۗ وَلَوْ  
ءَامَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ ۚ مِّنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿١٠١﴾

*“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.” (Ali Imran, 110)*

كَانُوا قَلِيلًا مِّنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ ﴿١٠١﴾ وَبِالْأَشْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ ﴿١٠٢﴾

*“Ata qenë të cilët pak flinin natën. 18. Dhe në syfyr (kah mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet.” (edh-Dharijat, 17-18)*

وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ وَأَنْتَ فِيهِمْ وَمَا كَانَ اللَّهُ مُعَذِّبَهُمْ وَهُمْ يَسْتَغْفِرُونَ ﴿٣٣﴾

*Po All-llahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) je në mesin e tyre dhe All-llahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfarë).“ (el-Enfalë, 33)*



## Kapitulli IV: VEÇORITË E KULTURËS SË MUSLIMANIT MODERN

---

Ajo që mëtojmë në këtë kapitull ka të bëjë me përshkrimin e disa prej veçorive të Kulturës Islame, me të cilat ajo dallohet prej kulturave të tjera. Me 'Kulturë Islame' nënkuptojmë kulturat e të gjithë popujve muslimanë, kulturën e Ummetit, andaj kriter në këtë kulturë është të qenit 'islame' apo e përvetësuar nga Kur'ani, Sunneti dhe tradita e të parëve tanë (selefitë).

Në vazhdim do të përmendim disa veçori të përshkruara nga dijetarët bashkëkohorë, ndërsa ne do të sjellim edhe argumentet përkatëse nga Kur'ani, duke bërë edhe shpjegime konkrete.

- 1) **Hyjnore.** (ثقافة ربانية) Kultura jonë ka sfond hyjnor. Ajo është shpallur prej Allahut të Madhëruar. Kjo për shkak se koncepti islam është koncept dhe perceptim hyjnor. Islami është fe e plotësuar dhe nuk ka nevojë të plotësohet nga askush. Është udhëzim, dritë, mëshirë dhe lumturi. Është kulturë e begatshme dhe e mirë, kulturë së cilës muslimani i përmbahet me besnikëri, kënaqësi, kulturë me të cilën ai jeton dhe bashkëvepron. Është kulturë me burim hyjnor, qasje hyjnore, veprim hyjnor, të vërteta hyjnore, perceptime hyjnore, kulturë me rezultate dhe fryte hyjnore. Parimet e saj janë madhështore, ato janë të zhveshura nga gabimet, injoranca, të metat, ato nuk bien ndesh me të dhënat shkencore dhe as që ka kundërthënie ndërmjet saj dhe shkencës. Është kulturë e mishëruar me natyrshmërinë e pastër njerëzore. Ajetet në vijim aludojnë për këtë karakteristikë të kulturës islame:

يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ  
وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٦﴾

*“All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë.”* (el-Maide, 16)

فَذَلِكُمْ اللَّهُ رَبُّكُمُ الْحَقُّ فَمَاذَا بَعَدَ الْحَقِّ إِلَّا الضَّلَالُ فَأَنَّى تُصِرُّونَ ﴿٣٢﴾

*“E ky është All-llahu, Zoti juaj i vërtetë. Pas të vërtetës nuk ka tjetër pos iluzione, e si po ia ktheni shpinën (të vërtetës)?”* (Junus, 32)

أَفْحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ ﴿٥٠﴾

*“A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më të mirë se ai i All-llahut?”* (el-Maide, 50)

أَفْحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ ﴿٩﴾

*“Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.”* (el-Isra, 9)

وَإِن تَطَّعْ أَكْثَرَ مَنْ فِي الْأَرْضِ يُضِلُّوكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ إِن يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ هُمْ إِلَّا  
يَخْرُصُونَ ﴿١١٦﴾

*“Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e All-llahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë.”* (el-En'amë, 116) <sup>42</sup>

- 2) **Gjithëpërfshirëse.** (ثقافة شمولية) Kjo nënkupton se Kultura Islame i përfshin të gjitha aspektet e jetës. Islami është fe dhe sistem i plotë, është fe dhe

<sup>42</sup> Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel ifitahi vel ingilak*, f. 19; Mursafi, Seid. (2005) *Eth-thekafetu el-islamijeh ve etheruha fi tekvini-sh-shahsijjeti-l-islamijeh*, f. 30-45; Izetbegoviq, Alija. (1994) *El-Islamu bejne-sherki ve-l-garbi*, f. 93-207.

shtet, besim dhe adhurim, ligjvënës dhe ekzekutues, shariat dhe kanun, mus'haf dhe shpatë, xhihad dhe da've (thirrje), politikë dhe ekonomi, dije dhe edukatë, udhëzim dhe shkencë. Ndërsa nga pasqyrimet e kësaj karakteristike do të veçonim: Njëshmërinë në adhurim (Teuhid el-uluhijeh), që nënkupton veçimin e Allahut me adhurim dhe besim; të vërtetën për njeriun dhe qenien e tij, ai është tredimensional: mendje, shpirt dhe trup; në këtë dhe botën tjetër, të cilat nuk i sheh të ndryshme dhe kundërthënëse, por i sheh si dy botë të plota, njëra prej të cilave i paraprin tjetrës për të qenë si vendmbjellje e saj. Ja disa nga ajetet kur'anore që aludojnë në këtë:

وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ نَقِيرًا ﴿١٦٤﴾

*“Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtarë, të tillët hyjnë në xhenet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie.”* (en-Nisa, 124)

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَدْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَآفَّةً وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۚ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ ﴿٢٠٨﴾

*“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armiku juaj i hapët.”* (el-Bekare, 208)

وَأَنْ أَحْكَمَ بَيْنَهُمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَأَحْذَرَهُمْ أَنْ يَفْتِنُوكَ عَنْ بَعْضِ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ ۗ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَاعْلَمُوا أَنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُصِيبَهُمْ بِبَعْضِ ذُنُوبِهِمْ ۗ وَإِنَّ كَثِيرًا مِنَ النَّاسِ لَفَاسِقُونَ ﴿٤١﴾

*“(Ta zbritëm) Që edhe ti të gjykosh me atë që të zbriti All-llahu, e mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju rrezikut të tyre që të mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-llahu. Nëse ata refuzojnë (gjykimin tënd), ti*

dije se All-llahu ka për qëllim t'i ndëshkojë për disa mëkate të tyre. Në të vërtetë, një shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës.” (el-Maide, 49)

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ حَرَجًا

مِمَّا قَضَيْتَ وَوَسَّلِمُوا تَسْلِيمًا ﴿٤٥﴾

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht.” (en-Nisa, 65)

إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَنُورٌ تَحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ الَّذِينَ أَسْلَمُوا لِلَّذِينَ هَادُوا وَالرَّبَّيُّونَ

وَالْأَحْبَابُ بِمَا اسْتَحْفَظُوا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ وَكَانُوا عَلَيْهِ شُهَدَاءَ ۚ فَلَا تَخْشَوُا النَّاسَ وَآخِشُوا

وَلَا تَشْتَرُوا بِعَآئِنِي ثَمَنًا قَلِيلًا ۚ وَمَنْ لَمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ ﴿٤٥﴾

وَكَتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذُنَ بِالْأُذُنِ

وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ ۚ فَمَنْ تَصَدَّقَ بِهِ ۖ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَّهُ ۚ وَمَنْ لَمْ يَحْكَمْ بِمَا

أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٤٥﴾ =

“Ne e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjyquan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamberët që ishin të bindur, gjyquan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e All-llahut dhe ishin mbrojtës të tij. Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, vetëm Mua të më frikësoheni dhe mos i ndërroni argumentet e Mia për pak send. E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues. 45. Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmaset ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e fal atë (hakmarrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë).” (el-Maide, 44-45)

وَالَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمْ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَمْرُهُمْ شُورَى بَيْنَهُمْ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ ﴿٧٨﴾ =

*“Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë.”* (esh-Shura, 38) <sup>43</sup>

- 3) **Kulturë e ekuilibruar dhe e matur mirë.** (ثقافة متوازنة) Kjo karakteristikë ka një lidhje të fuqishme me karakteristikën paraprake. Kultura Islame është kulturë e përgjithshme, mesatare, në të cilën nuk ka ekstremizëm të asnjërës anë. Ajo shquhet për ndërlidhje, harmoni dhe bashkëveprim. Ajo ia njeh çdokujt të drejtën dhe nuk i bën askujt padrejtësi. Ajo ka peshoren më të saktë të mundshme, peshore e cila nuk e dëmton askënd. Dhe kështu duhet të zhvillohet jeta. Allahu aludon për këtë në Kur’an:

وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ ﴿٧٩﴾ أَلَّا تَطْغَوْا فِي الْمِيزَانِ ﴿٨٠﴾ =

*“Ai e ngriti edhe qiellin dhe Ai vuri drejtësinë. 8. Që të mos kaloni kufirin në drejtësi.”* (err-Rrahman, 7-8)

Dukuria e drejtpeshimit apo balancimi është e pranishme në gjithësi, në krijimin e njeriut dhe në çdo gjë tjetër.<sup>44</sup> Specifikë e mesatares (drejtpeshimit) është se ajo i përshtatet më së shumti një misioni të përhershëm, ajo nënkupton drejtësi, por edhe qëndrim të fortë dhe stoik në fe. Mesatarja nënkupton edhe dallimin për të mirë, ajo nënkupton sigurinë dhe forcën, sikurse që përfaqëson edhe qendrën e unitetit. Allahu thotë:

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ وَيَكُونَ الرَّسُولُ عَلَيْكُمْ شَهِيدًا ۗ

وَمَا جَعَلْنَا الْقِبْلَةَ الَّتِي كُنْتَ عَلَيْهَا إِلَّا لِنَعْلَمَ مَنْ يَتَّبِعَ الرَّسُولَ مِمَّنْ يَنْقَلِبُ عَلَىٰ عَقْبَيْهِ ۗ وَإِن

كَانَتْ لَكَبِيرَةً إِلَّا عَلَى الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ ۗ وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُضِيعَ إِيمَانَكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ بِالنَّاسِ

لَرَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿١٢٣﴾ =

<sup>43</sup> Xhunejdi, Abdullah Shakir. (2004) *Muhadaratun fi-th-thekafeti-l-islamijeh*, f. 93-133.

<sup>44</sup> Kardavi, Jusuf. (1997) *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*, f. 129-131; Seid, Hemmam & Halidi, Salah. (2002) *El-vexhiz fi-th-thekafeti-l-islamijeh*, f. 89-94.

*“Dhe ashtu (siç ju udhëzuar në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush. E Kiblen nga e cila ti u drejtove nuk e bëmë për tjetër, vetëm se për të provuar atë që shkon pas të dërguarit, nga ai që kthehet prapa, ndonëse kjo ka qenë vështirë (për disa), por jo edhe për ata që All-llahu i drejtoi. All-llahu nuk është që t'ua humbë besimin tuaj. S'ka dyshim se All-llahu është shumë i butë dhe mëshirues ndaj njerëzve.”* (el-Bekare, 143)

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ  
 = وَلَوْ ءَامَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ مِّنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿١١٠﴾

*“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.”* (Ali Imran, 110)

Ndërsa sa i përket reflektimeve të mesatares në Islam dhe fushave të saj në besim, adhurim dhe etikë<sup>45</sup>, ato i mësojmë dhe kuptojmë nga përshkrimi që Allahu i Madhëruar iu bën programeve të të Dërguarve të Tij:

فَأَسْتَجِبْنَا لَهُ وَوَهَبْنَا لَهُ يَحْيَىٰ وَأَصْلَحْنَا لَهُ زَوْجَهُ ۗ إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ  
 = وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا ۗ وَكَانُوا لَنَا خَشِيعِينَ ﴿٤٦﴾

*“Ne ia pranuar lutjen atij, ia dhuruam atij Jahjain dhe ia përmirësuam bashkëshorten atij. Ata përpiqeshin për punë të mira, Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh.”* (el-Enbija, 90.)  
 Mesataren apo drejtpeshimin mund ta vërejmë në fusha të ndryshme: njeriu është i urdhëruar ta adhurojë Zotin e vet, siç thotë Allahu:

قُلِ اللَّهُ أَعْبُدُ مُخْلِصًا لَهُ دِينِي ﴿١٤٠﴾

*Thuaj: "Vetëm All-llahun e adhuroj, sinqerisht ndaj Tij e bëj adhurimin*

<sup>45</sup> Kardavi, Jusuf. (1997) *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*, f. 130-141.

tim.“ (ez-Zumer, 14)

...por, paralel me këtë është i urdhëruar të kujdeset edhe për familjen, rrethin dhe shoqërinë e tij. Madje, kjo edhe llogaritet si formë e adhurimit. Allahu thotë:

يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا مَلَائِكَةٌ غِلَاظٌ شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ ﴿٦﴾ =

*“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar.”* (et-Tahrim, 6.)

وَأَتَّبِعْ فِيْمَا ءَاتَاكَ اللَّهُ الدَّارَ الْآخِرَةَ ۗ وَلَا تَنْسَ نَصِيبَكَ مِنَ الدُّنْيَا ۗ وَأَحْسِنَ كَمَا أَحْسَنَ اللَّهُ إِلَيْكَ ۗ وَلَا تَبْغِ الْفَسَادَ فِي الْأَرْضِ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ ﴿٧٧﴾ =

*“Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit.”* (el-Kasas, 77)

Njeriu është i urdhëruar të shpenzojë në rrugën e Allahut, por jo duke shfaqur ekstravagancë. Allahu thotë:

وَلَا تَجْعَلْ يَدَكَ مَغْلُولَةً إِلَىٰ عُنُقِكَ وَلَا تَبْسُطْهَا كُلَّ الْبَسْطِ فَتَقْعُدَ مَلُومًا مَّحْسُورًا ﴿٢٩﴾ =

*“Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac), e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt).”* (el-Isra, 29)

﴿ يَبْنِي ۖ ءَادَمَ خُدُوًا زَيْنَتَكُمْ عِنْدَ كُلِّ مَسْجِدٍ وَكُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا ۚ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ ﴿٣١﴾ =

*“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).”* (el-A’rafë, 31.)

Duke meditar rreth këtyre ajeteve ne mund të kuptojmë thellësisht mesataren dhe drejtpeshimin në Islam<sup>46</sup>.

- 4) **Realiste.** (ثقافة واقعية) Sheriati Islam nuk e obligon njeriun përtej mundësive të tij. Duke shfletuar disa pjesë nga Kur'ani dhe duke meditar për domethëniet madhështore të tyre ne mund të përfundojmë tek kjo e vërtetë. Allahu thotë:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا اكْتَسَبَتْ رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ دُسِينَا  
 أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إَصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا  
 تُحْمِلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ ۗ وَاعْفُ عَنَّا وَأَغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا ۗ أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ  
 الْكَافِرِينَ ﴿٢٨٦﴾ =

*"All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij, atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi. "Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! Na i shlyej mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit pabesimtar!" (el-Bekare, 286.)*

أَيَّامًا مَعْدُودَاتٍ ۗ فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ ۗ وَعَلَىٰ الَّذِينَ  
 يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ ۗ فَمَنْ تَطَوَّعَ خَيْرًا فَهُوَ خَيْرٌ لَهُ ۗ وَأَنْ تَصُومُوا خَيْرٌ لَّكُمْ ۗ إِن  
 كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٨٧﴾ =

*"(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor) i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i*

<sup>46</sup> Salih Hindi dhe të tjerë. (2000) *Eth-thekafetu el-islamijeh*, f. 97-107.



mirë për ju.“ (el-Bekare, 184)

وَالَّذِينَ فِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ مَّعْلُومٌ ﴿١٨٤﴾ لِلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ ﴿١٨٥﴾ =

“Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar. 25. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp.“ (el-Mearixh, 24-25.)

﴿١٨٥﴾ يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّ كَثِيرًا مِّنَ الْأَحْبَارِ وَالرُّهْبَانِ لِيَآكُلُونَ أَمْوَالَ النَّاسِ بِالْبَاطِلِ

وَيُصَدُّونَ عَن سَبِيلِ اللَّهِ ۗ وَالَّذِينَ يَكْتُمُونَ الذَّهَبَ وَالْفِضَّةَ وَلَا يُنْفِقُونَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ

فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿١٨٦﴾ =

“O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudive dhe e të krishterëve, në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinë e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e All-llahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e All-llahut, lajmëroi për një dënim të dhembshëm.“ (et-Teube, 34.)

لِلْفُقَرَاءِ الَّذِينَ أَحْصَرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا يَسْتَطِيعُونَ ضَرْبًا فِي الْأَرْضِ يَحْسَبُهُمُ

الْجَاهِلُ أَغْنِيَاءَ مِنَ التَّعَفُّفِ تَعْرِفُهُمْ بِسِيمَاهُمْ لَا يَسْأَلُونَ النَّاسَ إِحْآفًا ۗ وَمَا

تُنْفِقُوا مِن خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ ﴿١٨٧﴾ =

“(Jepni) për të varfrit që janë të angazhuar në rrugën e All-llahut dhe nuk kanë mundësi të gjallërojnë me tokë, duke qenë se ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzitin njerëzit. Pra çkado që të jepni nga pasuria, s'ka dyshim se atë All-llahu e di shumë mirë.“ (el-Bekare, 273)

وَلِيَخْشَ الَّذِينَ لَوْ تَرَكُوا مِن خَلْفِهِمْ ذُرِّيَّةً ضِعْفًا خَافُوا عَلَيْهِمْ فَلْيَتَّقُوا اللَّهَ وَلْيَقُولُوا قَوْلًا

سَدِيدًا ﴿١٨٨﴾ =

“Le të frikësohen ata (në prag të vdekjes) sikur të linin pas vete pasardhës të paaftë për të cilët kanë dro (si do të jetë gjendja e tyre) le t'i ruhen All-

*llahut (dënimit të Tij) dhe le t'ju thonë (jetimëve) fjalë prindërore.“* (en-Nisa, 9.)

Ligjet islame e kanë parasysh natyrën e njeriut, i cili mund të jetë i fortë por edhe i dobët, i ditur por edhe injorant, i lumtur por edhe i pikëlluar. Shembuj të kësaj natyre ka shumë. Feja ia ka lejuar njeriut, në raste të caktuara, edhe përdorimin e gjërave të ndaluara, sikurse që i ka lënë hapësirë që në mungesë të diçkaje, që parimisht është e obliguar, të përdoret diç tjetër si alternativë, si p.sh: dheu për abdes në mungesë të ujit.<sup>47</sup>

- 5) **Moraliste.** (ثقافة أخلاقية) Morali dhe etika kanë rëndësi të pashoqe. Për këtë shkak, morali në Islam përfshin një kapitull të gjerë, madje është bosht i fesë, sikurse që është lidhur me objektiva dhe synime shumë madhështore. Islami përcaktoi shpërblim dhe ndëshkim për moralin. Ai e çliroi njeriun nga arroganca e injorancës, ndërsa moralit i dha vendin më të lartë kur deklaroi se ai është motoja e misionit të Muhammedit [alejhis salatu ves selam]:

إِنَّمَا بُعِثْتُ لِأَتَمِّمَ مَكَارِمَ الْأَخْلَاقِ

*Unë jam dërguar për të përsosur moralin!”*<sup>48</sup>

Në të ka mësim për të gjithë, për çdo gjë në jetë, që nga tryeza e bukës në shtëpi e deri tek ndërtimi i shtetit. Islami konsideron se morali është fryt i besimit të vërtetë dhe adhurimit të sinqertë. Allahu thotë:

يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ وَلَا تَجَسَّسُوا وَلَا يَغْتَبَ

بَعْضُكُم بَعْضًا ؕ أَحِبُّوا أَحَدُكُمْ أَن يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ ؕ وَاتَّقُوا اللَّهَ ؕ إِنَّ اللَّهَ

= تَوَابٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢﴾

*“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga*

<sup>47</sup> Ahmed Ferr-rraxh dhe të tjerë. *Hasaisu-th-thekafeti-l-arabijjeti-l-islamijeh*, f. 19-34.

<sup>48</sup> E transmeton Buhariu në *Edebu-l-mufred*, f. 50.

*ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.*" (el-Huxhurat, 12)

Kultura jonë nuk pranon klasifikim të moralit: që me dikë të sillesh mirë e me të tjerët keq. E mira është e mirë për të gjithë, e po kështu edhe e keqja. Hallalli është hallall për të gjithë, sikur që harami është haram për të gjithë. Në kulturën islame nuk aplikohet metoda selektive, siç veprohet ta zëmë tek çifutët, ku kamata ndërmjet çifutëve është e ndaluar, por jo edhe ndaj të tjerëve.<sup>49</sup> Nga këtu, në kulturën tonë morali dhe vepra nuk ndahen, sikurse që nuk ndahen as morali dhe dija, morali dhe ekonomia, morali dhe politika, morali dhe lufta<sup>50</sup>.

- 6) **Njerëzore.** (ثقافة إنسانية) Konsiderata për aspektin njerëzor të njeriut është një nga veçoritë më të spikatura të Kulturës Islame. Islami ka ardhur për ta nderuar njeriun, për t'ia plotësuar nevojat dhe për t'ia përmbushur kërkesat, ngase njeriu është një krijesë e nderuar. Allahu thotë:

﴿ وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ وَحَمَلْنَاهُمْ فِي الْوَجْرِ وَالْبَحْرِ وَرَزَقْنَاهُمْ مِنَ الطَّيِّبَاتِ وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَىٰ كَثِيرٍ مِّمَّنْ خَلَقْنَا تَفْضِيلًا ﴾ = ﴿٧﴾

*"Ne vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësua të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësua ata (i lartësua) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam."* (el-Isra, 70)

Njeriu është mëkëmbësi i Allahut në tokë, atij i janë nënshtruar toka dhe qiejt. Njeriu, para se të jetë i nderuar me fenë, është i nderuar me njerëzinë e tij. Allahu thotë:

﴿ وَإِلَىٰ عَادِ أَخَاهُمْ هُودًا ۚ قَالَ يَا قَوْمِ أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنِّي غَيْرُهُ ۗ إِنَّا أَنتمُ إِلَّا مُفْتَرُونَ ﴾ = ﴿٧٠﴾

*"Edhe tek (populli) Adi (dërguam) nga mesi tyre Hudin që tha: "O populli*

<sup>49</sup> Devle, Muhammed Ali. (2001) *El-jehud el-mu'tedune ve devletuhum Israil fi muel-lefati Muhammed el-Gazali*, f. 99-103.

<sup>50</sup> Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, f. 23-24; Gazali, Muhammed. (2003) *Dusturu-l-vahdeti-th-thekafijeh bejne-l-muslimine*, f. 99-106.

*im adhuroni All-llahun, ju nuk keni zot tjetër pos Tij, ju vetëm po hutoheni me trillime".*“ (Hud, 50)

﴿ وَإِلَىٰ ثَمُودَ أَخَاهُمْ صَالِحًا ۚ قَالَ يَا قَوْمِ أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِن إِلَهِ غَيْرُهُ ۗ هُوَ أَنشَأَكُم مِّنَ الْأَرْضِ وَأَسْتَعْمَرَكُمْ فِيهَا فَاسْتَغْفِرُوهُ ثُمَّ تَوْبُوا إِلَيْهِ ۚ إِنَّ رَبِّي قَرِيبٌ مُّجِيبٌ ﴿٦١﴾ =

*“Edhe te (populli) Themud e patëm dërguar njërin prej tyre, Salihun, e ai u tha: "O populli im, adhurojeni All-llahun, ju nuk keni ndonjë zot tjetër pos Tij, Ai së pari ju krijoi nga dheu dhe ju bëri banues të tij, andaj kërkoni falje prej Tij, dhe shprehni pendim tek Ai. S'ka dyshim, Zoti im është afër (me mëshirë), Ai përgjigjet (lutjeve)"!*“ (Hud, 61)

﴿ وَإِلَىٰ مَدْيَنَ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا ۚ قَالَ يَا قَوْمِ أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِن إِلَهِ غَيْرُهُ ۗ قَدْ جَاءَتْكُم بَيِّنَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ ۗ فَأَوْفُوا الْكَيْلَ وَالْمِيزَانَ وَلَا تَبْخَسُوا النَّاسَ أَشْيَاءَهُمْ وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا ۚ ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿٨٥﴾ =

*“E në Medjen (dërguam) vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha: "O populli im, adhurojeni All-llahun (Një), ju nuk keni zot tjetër pos Tij. Juve ju erdhi mrekullia nga Zoti juaj. Zbatoni drejt matjen dhe peshojën, e mos u bëni padrejtësi njerëzve në sendet e tyre, dhe mos bëni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj. Këto janë më të dobishme për ju, nëse jeni besimtarë".*“ (el-A'rafë, 85)

Pejgamberët [alejhimus selam], siç kanë nënvizuar dijetarët, ndonëse janë dalluar në besim, bindje dhe praktika me popujt e tyre, kanë qenë vëllezër me ta nga ky aspekti i njerëzshmërisë së tyre. Në Sahihun e Buhariut transmetohet se Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ishte ngritur në këmbë kur pranë tij kishte kaluar një kufomë. Atij i thanë se ajo ishte kufoma e një çifuti. ‘Po ky a nuk është njeri?’ – ua ktheu ai. ‘Po, o i Dërguari i Allahut, ashtu është,’ – i thanë ata. ‘Çdo njeri në Islam ka respekt dhe pozitë,’ – u tha ai.<sup>51</sup>

7) **Universale.** (ثقافة عالمية)Kultura jonë islame është kulturë me karakter

<sup>51</sup> Kardavi, Jusuf. (1997) *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*, f. 57-99.

mbarëbotëror. Motoja, mesazhi dhe vizioni i saj janë të atilla që nuk bëjnë përjashtime për askënd. Përkundrazi, të mirët i dallon vetëm mirësia dhe devotshmëria. Allahu thotë:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاهُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۗ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾ =

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (el-Huxhurat, 13)*

﴿١٥﴾ يَتَأْتِيهَا النَّاسُ أَنْتُمْ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ ﴿١٥﴾ =

*“O ju njerëz, ju keni nevojë për All-llahun e All-llahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari.” (Fatir, 15)*

﴿٥٩﴾ إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ ۗ خَلَقَهُ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُن فَيَكُونُ ﴿٥٩﴾ =

*“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek All-llahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: "Bëhu"! e ai u bë.” (Ali Imran, 59)*

﴿١١٤﴾ يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ ۚ أُولَٰئِكَ يُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَأُولَٰئِكَ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿١١٤﴾ =

*“I besojnë All-llahut dhe ditës së gjykimit, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të këqijat, përpiqen për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve.” (Ali Imran, 114)*

Për këtë shkak, në mesin e shoqërisë muslimane mund të vëresh elementë të përzier: të bardhë e të zi, të pasur e të varfër, gjë që nuk mund ta vëresh askund tjetër. Këtu dua të ripërsëris se nuk ka kundërthënie ndërmjet të qenit të kulturave tona kultura lokale, si: shqiptare, turke, arabe, dhe të qenit të tyre islame universale, pasi që Islami është universal dhe në të ka hapësirë për të gjithë. Ajo nuk është sikurse kulturat e tjera, p.sh. ajo çifute,

që glorifikon një shtresë dhe përdhos shtresat e tjera. Allahu ka thënë:

= ﴿٢٠﴾ يَتَأْتِيهَا النَّاسُ أَعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar).”* (el-Bekare, 21.)

= ﴿٢١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

*“Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve!”* (el-Fatiha, 2)

= ﴿٢٤﴾ وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

*“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”* (el-Enbija, 107)

﴿٢٥﴾ قُلْ يَتَأْتِيهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَا

إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ

= ﴿٢٦﴾ وَكَلِمَتِهِ وَأَتَّبِعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ

*“Thuaj (Muhammed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i All-llahut te të gjithë ju. All-llahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s’ka të adhuruar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni All-llahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson All-llahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën.”* (el-A’rafë, 158.)

52

- 8) **Tolerante.** (ثقافة متسامحة) Kultura jonë dallon nga të tjerat edhe për tolerancën që ka në raport me to, tolerancë të cilën në fakt e ndërton mbi dy parime bazë:

- a) Dallimet ndërmjet njerëzve në fe dhe kultura janë me dëshirën dhe urtësinë e Allahut. Allahu thotë:

﴿١١٨﴾ وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً ۗ وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ ۗ إِلَّا مَن رَّحِمَ

<sup>52</sup> Abdul Hakk Ibn Hakki Turkmani & Fet’hi Ibn Abdullah el-Musuli. (2010) *Et-teamul mea gajril muslimine fi-s-sunneti-n-nebevijeh*, f. 29-89; Kardavi, Jusuf. (2005) *Mebadi fi-l-hivari ve-t-takribi bejne-l-medhahib el-islamijeh*, f. 13-103.

رُبُّكَ ۚ وَلِذَلِكَ خَلَقَهُمْ ۖ وَتَمَّتْ كَلِمَةُ رَبِّكَ لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ

= ﴿١١٩﴾

*“Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete), 119. Përveç atij që e mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata. Fjala e Zotit tënd: "Gjithsesi do ta mbush xhehenemin me të gjithë exhinët dhe njerëzit", ka marrë fund (është plotësuar).“ (Hud, 118-119)*

- b) Llogaria për devijimin dhe lajthitjen e njerëzve është punë me të cilën merret Allahu në Ditën e Kiametit dhe askush nga njerëzit në këtë botë. Allahu thotë:

فَلِذَلِكَ فَادَعُ ۖ وَأَسْتَقِمْ ۖ كَمَا أُمِرْتَ ۖ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ ۖ وَقُلْ ءَامَنْتُ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ ۖ مِنْ كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ ۖ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ ۖ لَنَا أَعْمَلْنَا وَلَكُمْ أَعْمَلِكُمْ ۖ

لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمُ ۖ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ﴿١٥﴾ =

*“E për këtë shkak (të përçarjes së tyre), ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre dhe thuaj: "Unë kam besuar në librat që i shpalli All-llahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, All-llahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj; Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh e jush; All-llahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm tek Ai është përfundimi!".“ (esh-Shura, 15)*

ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ ﴿١٦﴾ =

*“Dhe vetëm detyrë Jona është llogaria e tyre.” (el-Gashije, 26)*

إِنَّ حِسَابَهُمْ إِلَّا عَلَىٰ رَبِّي لَوَ تَشْعُرُونَ ﴿١٧﴾ =

*“Përgjegjësia e tyre, nëse kuptoni, është vetëm para Zotit tim.” (esh-Shuara, 113)*

Këtu fshihet sekreti pse Kultura Islame është një shesh i gjerë që përfshin

fe, raca, ngjyra dhe gjuhë të ndryshme dhe pse askush nuk është diskriminuar kurrë mbi këto baza. Që të gjithë kanë sigurinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij [alejhîs salatu ves selam]<sup>53</sup>.

**9) Me përbërje të larmishme.** (ثقافة متنوعة) Pjesë e kësaj kulture është feja me të gjitha parimet e saj, është gjuha, letërsia dhe filozofia, janë shkencat shoqërore dhe matematikore, janë artet e ndryshme. Në të ka fikh të Ebu Hanifes dhe shkollës racionale, fikh të Malikut dhe shkollës tradicionale, ka apologjetikë esh'arijjane dhe tefsir të Taberiu, ka letërsi të Xhahidhit, fjalor të Halilit dhe sintaksë të Sibevejhit. Në të ka sofizëm të Gazaliut, filozofi të Ibni Rushdit, në të është edhe Imam Ahmedi nga Iraku, Ibni Tejmije nga Shami, Ibnul Arabiu nga Maroku, Ibni Haxheri nga Egjipti, Shirazi nga Irani, Dehleviu nga India, Xhelaluddin Rumi nga Turqia... Në të janë librat e shkruara dhe imazhet e shikuara... Xhamia Emevijje në Sham, ajo Hamra në Spanjë, Ez'heri në Egjipt, Sulltan Ahmeti në Turqi... Është një larmi vlerash, një pasuri e rrallë, por jo edhe çdo pjesë e saj vlen për t'u mbështetur në të apo për të përfaqësuar Ummetin në tërësi. Madje, ajo që dua të theksoj këtu është se armiqtë e Islamit, orientalistët në mënyrë të veçantë, fokusohen pikërisht në këto aspekte të lajthitura, që assesi nuk përfaqësojnë kulturën islame. Pjesë e kulturës sonë janë edhe ato që realisht nuk i duam, por ja që janë pjesë e saj. Këtë nuk mund ta mohojmë dhe as ta zhdukim. Pjesë e kësaj kulture është dhe sofizmi i Xhunejdit dhe prapësitë e Hal-laxhit, sikurse që janë edhe devotshmëria e pasuesve dhe lajthitjet e risimtarëve. Në të hyjnë edhe thëniet e fraksioneve, të cilat në fakt nuk i duam dhe nuk na pëlqejnë, por ja që janë futur si pjesë e kësaj trashëgime, kështu që ato nuk duhet të jenë në dispozicion për të gjithë, por vetëm për profesionistët e fushave të caktuara, për të cilët nuk ekziston frika se mund të ndikohen prej tyre. Fakti se janë pjesë e saj nuk nënkupton se ato duhet të kultivohen, kjo gjë duhet dalluar qartë. Dijetarët e kanë obligim ta edukojnë Ummetin në frymën e besimit të pastër dhe kulturës që buron prej tij, kulturës e cila

---

<sup>53</sup> Shih: Fejsal Seid Balamsh dhe të tjerë. (2007) *Eth-the kafetu el-islamijetu* III, f. 194-220; Kardavi, Jusuf. (2005) *Mebadi fi-l-hivari ve-t-takribi bejne-l-medhahib el-islamijeh*, f. 13-103; El-Imamani el-Bruxherdi ve Sheltut - Raida et-takribi mexhmuatu mekalatin - el-multeka ed devlijj li tekrimi el-Imamejni, f. 20-50



është moto e këtij Ummeti, kulturës e cila nuk sheh ndonjë pengesë që të përvetësojë të mirat<sup>54</sup>. Allahu thotë:

الَّذِينَ يَسْتَمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَاهُمُ اللَّهُ وَأُولَئِكَ هُمْ أُولُوا  
= الألباب ﴿١٨﴾

*“Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.”* (ez-Zumer, 18.)

10) **Plotësuese dhe përmirësuese e kulturave të mëparshme.** ثقافة مكملة للثقافات  
الدينية السابقة)


Kultura jonë plotësohet në vetvete. Kultura gjuhësore plotëson atë fetare dhe anasjelltas. Kultura Islame është deklaruar sheshazi si plotësuese e kulturave të tjera. Apo, thënë më qartë, ajo vazhdon misionin e pejgamberëve duke bërë spastrimin e elementeve të huaja të futur në të. Allahu thotë:

وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ هُوَ الْحَقُّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ إِنَّ اللَّهَ بِعِبَادِهِ لَخَبِيرٌ بَصِيرٌ  
= ﴿٣١﴾

*“Dhe ajo që Ne të shpallëm ty nga libri, është e vërtetë e saktë, që vërteton edhe për ata që ishin para tij. Vërtet, All-llahu është hollësisht i njohur ndaj robërve të vet, i sheh të gjitha.”* (Fatir, 31)

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ  
فَأَحْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ عَمَّا جَاءَكَ مِنَ الْحَقِّ لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ  
شُرْعَةً وَمِنْهَا جَا وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لَيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا

<sup>54</sup> Kardavi, Jusuf. *Thekafetuna bejne-l-iftitahi ve-l-ingilak*, f. 25-30; Kardavi, Jusuf. (1997) *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*, f. 57-99; Gazali, Muhammed. (2005) *Sirr-rru te'ehhuri-l-arab ve-l-muslimine*, f. 71-139.

=  إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ

*“Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur'anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Gjyko pra mes tyre me atë që All-llahu e zbriti, e mos pëlqe epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte All-llahu, do t'ju bënte një popull (në fe e sheriat), por deshi t'ju sprovojë në atë që ua dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquuni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është tek All-llahu, e Ai do t'ju njoftojë për atë që kundërshtoheshit.”* (el-Maide, 48)  
Pejgamberi ynë [alejhis salatu ves selam] është dërguar për të plotësuar dhe përsosur moralin:

إِنَّمَا بُعِثْتُ لِأَتَمِّمَ مَكَارِمَ الْأَخْلَاقِ

*Unë, jam dërguar për ta përsosur moralin!”*<sup>55</sup>

Morali i mirë ka qenë, është dhe do të mbetet në këtë botë.<sup>56</sup>

Këto ishin disa nga veçoritë e Kulturës Islame, ndërsa në kapitullin vijues do të bëjmë fjalë për raportet e saj me kulturat e tjera.

=  
=  
=  
=  
=

<sup>55</sup> E transmetojnë Tirmidhiu në kapitujt e Diturisë, nr. 2688 dhe Ibni Maxheh në Zuhd, nr. 4169.

<sup>56</sup> El-Eshkar, Omer Sulejman. *Nahve thekafetin islamijjetin esileh*, f. 249-269. Shih dhe revistën shkencore Edjan, të cilën e nxjerr Qendra Ndërkombëtare për Dialog Ndërfetar në Doha, nr. 2, 2011, f. 115-127.

## **Kapitulli V:**

# **RAPORTET E KULTURËS SË MUSLIMANIT BASHKËKOHOR ME KULTURAT E TJERA**

---

Tash, pasi që u njohëm me karakteristikat e kulturës së muslimanit bashkëkohor, lind pyetja se çfarë raportesh kultivon ajo në raport me kulturat e tjera? Muhammed el-Emin esh-Shenkiti, një komentues i rrallë i Kur'anit Fisnik, jep shpjegime tejet domethënëse për qëndrimin e besimtarit musliman karshi kulturave të tjera, që përmbledhet në katër pika kryesore. Të shkëpusim diç nga fjalët e tij në lidhje me çështjen në fjalë.

“...realiteti dëshmon se kultura perëndimore ka gjëra të dobishme dhe të dëmshme. Sa i përket të parës, ajo ka të bëjë me aspektin material, pra me zhvillimin dhe përparimin në të gjitha fushat, madje edhe më shumë se që ishte paramenduar. Ajo, me këtë hap, njeriut – si qenie trupore e gjallë – i ka shërbyer shumë. Ndërsa sa i përket aspektit tjetër, pra atij të dëmshëm, ky ka të bëjë me neglizhimin e edukimit shpirtëror, i cili parimisht nuk mund të bëhet veçse me programin hyjnor, që ia përshkruan njeriut rrugën drejt lumturisë së dy botëve, si dhe e mban atë në lidhje të përhershme me Zotin e tij. Kësisoj, kultura perëndimore ka falimentuar për shkak të mbizotërimit të aspektit material ndaj atij shpirtëror, duke e kërcënuar edhe botën përreth. Zgjidhja e problemeve të saj nuk mund të ndodhë ndryshe veçse me dritën e shpalljes hyjnore, që është ligji i Krijuesit të qiejve dhe tokës, sepse ai, që është mashtruar nga materializmi aq sa e ka harruar edhe Zotin, nuk mund të shpëtojë ndryshe veçse duke iu kthyer Zotit. Ndërsa ndarja e vërtetë përkufizon edhe modalitetet e zgjidhjes, që në fakt është dhe qëndrimi karshi kulturës perëndimore. Kjo përkufizohet vetëm në katër pika:

- 1) Braktisja e tërësishme, pra refuzimi i të gjitha aspekteve të saj, të mirave dhe të këqijave;
- 2) Përvetësimi i tërësishëm, pa dalluar të mirën nga e keqja;
- 3) Përvetësimi i së keqes dhe braktisja e së mirës; dhe
- 4) Përvetësimi i së mirës dhe braktisja e së keqes.

Le të diskutojmë pak për këto katër qëndrime. Tri të parat, pa dyshim, janë shumë të gabuara, për shkak se bien ndesh me parimet islame. *E para*, nënkupton braktisjen e çdo gjëje, gjë që është e gabuar ngase ngelja mbrapa në avancimin teknologjik është gabim. Allahu thotë:

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ =

*"E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë)..."* (el-Enfalë, 60)

*E dyta*, është po kështu gabim, ngase përvetësimi në tërësi nënkupton edhe përvetësimin e moralit, që do të ishte një katastrofë e madhe për ne. Kultura perëndimore nuk është gjë tjetër veçse një rebelim i llojit të vet kundër Krijuesit dhe ligjit të Tij. Allahu thotë:

قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ لَكُمْ مِنْ رِزْقٍ فَجَعَلْتُمْ مِنْهُ حَرَامًا وَحَلَالًا قُلْ ءِاللَّهُ أَذِنَ لَكُمْ أَمْ عَلَى اللَّهِ تَفْتَرُونَ =

*Thuaj: "Më thoni, atë që All-llahu ju dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar?" Thuaj: "A ju lejoi All-llahu ju, ose ju shpifni për All-llahun?"* (Junus, 59)

أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ شَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ وَلَوْلَا كَلِمَةُ الْفَصْلِ لَفُصِّلَ لِقَاؤُهُمْ قُلْ إِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ =

*"A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e*

*urdhëroi All-llahu? Po sikur të mos ishte fjala vendimtare (e All-llahut që shpërblimi dhe ndëshkimi të jenë në Ahiret), do të kryhej dënimi mbi ta, e megjithatë, mohuesit do të kenë dënim të dhembshëm.” (esh-Shura, 21)*

Opsioni i tretë refuzohet për shkak të qasjes së papranuar që paraqet. Ai nënkupton përvetësimin e aspekteve negative, gjë kjo që refuzohet apriori. Kësisoj, mund të përfundojmë se opsioni i mbetur, i katërti, është i qëlluari, për shkak të korrektësisë dhe drejtpeshimit. Kështu veproi i Dërguari i Allahut [alejhissalatu ves selam]. Ai përfitoi nga hapja e hendekut në Betejën e Ahzabit, që si strategji ushtarake ishte e persianëve, sikurse që përfitoi edhe nga të tjerët gjëra të tjera të rëndësishme. Gjatë Hixhretit ai kishte angazhuar një jomusliman si udhërrëfyes. Si konkluzion mund të themi se qëndrimi ynë karshi kulturës perëndimore është që të marrim aspekte që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe avancimin teknologjik dhe t'i braktisim të tjerat, pasi që morali, etika dhe kultura jonë na mjaftojnë. Ky është parimi, por praktika, mjerisht, është ndryshe. Muslimanët kanë përvetësuar të kundërtën, duke rrezikuar kështu humbjen e dynjasë dhe ahiretit.

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَعْبُدُ اللَّهَ عَلَىٰ حَرْفٍ فَإِنْ أَصَابَهُ خَيْرٌ اطْمَأَنَّ بِهِ ۗ وَإِنْ أَصَابَتْهُ فِتْنَةٌ انْقَلَبَ عَلَىٰ  
وَجْهِهِ خَسِرَ الدُّنْيَا وَالْآخِرَةَ ۗ ذَٰلِكَ هُوَ الْخُسْرَانُ الْمُمِينُ ﴿١١﴾ =

**“Ka nga njerëzit që adhuron All-llahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai e ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë.” (el-Haxh, 11)**

Sa bukur është kur tek individi bashkohen feja dhe dynjaja dhe sa shëmtim është kur bashkohen pabesimi dhe falimentimi (humbja).<sup>57</sup>

Kështu, bazuar në këtë që thamë, mund të përfundojmë se kultura jonë në raport me të tjerët ngrihet mbi këto baza:

1) **Dallim, por edhe përfitim.** (التمييز والاستفادة) Muslimani duhet të dallohet nga

<sup>57</sup> Shenkiti, Muhammed Muhtar. (2007) *Tefsiru advai-l-bejan*. 4/381.

të tjerët në besim, adhurim dhe sjellje (edukatë), gjë për të cilën aludohet në Kur'an:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَلَوْ ءَامَنَ أَهْلُ  
الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ ۚ مِنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿١١٠﴾ =

*“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.”*  
(Ali Imran, 110)

وَلَا تُجَادِلُوا أَهْلَ الْكِتَابِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِلَّا الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ ۖ وَقُولُوا ءَامَنَّا بِالَّذِي أُنزِلَ إِلَيْنَا  
وَأُنزِلَ إِلَيْكُمْ وَإِلَهُنَا وَإِلَهُكُمْ وَاحِدٌ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ ﴿١١٣﴾ =

*“Me ithtarët e librit mos polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thojuni: “Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.”* (el-Ankebut, 46)

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَائِيلَ لَا تَعْبُدُونَ إِلَّا اللَّهَ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا وَذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ  
وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ ثُمَّ تَوَلَّيْتُمْ إِلَّا قَلِيلًا مِّنْكُمْ وَأَنْتُمْ مُّعْرِضُونَ ﴿١٣٠﴾ =

*“(Përkujtoni) Kur ne morëm zotimin e bijve të Israilit; mos adhuroni tjetërkë përveç All-llahut, të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve dhe njerëzve thojuni fjalë të mira. Faleni namazin dhe jepni zeqatin, e pastaj ju e thyet zotimin dhe përveç një pakice prej jush, ia kthyet shpinën zotimit.”* (el-Bekare, 83)

- 2) **Përputhje, jo pështjellim.** (توفيق لا تليف) Muslimani është i urdhëruar t'i harmonizojë parimet e kulturës së re të fituar me parimet e kulturës islame. Kjo është ajo që sot po e quajnë 'islamizim i dijes.' Procedura e përputhjes kalon nëpër disa faza ose realizohet nëpërmjet disa mjeteve, si: vlerësimi i asaj kulture sipas peshojës islame, në mënyrë që të bëhet filtrimi i saj nga çdo gjë që mund të jetë e papranuar në Islam. Kështu përputhjen mund ta bëjmë duke iu shmangur çdo gjëje që do të ishte e refuzuar nga këndvështrimi ynë islam. Ndoshta ajeti që do të përmendim në vijim

aludon në këtë domethënie. Allahu thotë:

يَتَأْتِي النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاهُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنثَىٰ وَجَعَلْنَاهُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۗ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتَقْوَاهُ ۗ  
= إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٥﴾

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”* (el-Huxhurat, 13)

- 3) **Pranim, jo shkrirje.** (قبول لا الذوبان) Muslimani duhet të pasojë rrugën e pejgamberëve dhe të përvetësojë metodën e tyre. Allahu duke na folur për metodat e tyre thotë:

فَأَسْتَجِبْنَا لَهُ ۖ وَوَهَبْنَا لَهُ ۖ يَحْيَىٰ وَأَصْلَحْنَا لَهُ ۖ زَوْجَهُ ۗ إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا ۗ وَكَانُوا لَنَا حَشِيعِينَ ﴿١٠٠﴾  
=

*“Ne ia pranuar lutjen atij, ia dhuruam atij Jahjain dhe ia përmirësuar bashkëshorten atij. Ata përpiqeshin për punë të mira. Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh.”* (el-Enbija, 90)

Në këtë ajet aludohet kjo që thamë. Muslimani intelektual, që ka dije për fenë dhe dynjanë e tij, nuk e pranon assesi shkrirjen dhe asimilimin në kulturat tjera. Islami është feja e vetme që i ruan identitetet etnike të njerëzve. Diversitetin e vlerëson si pasuri dhe si demonstrim të fuqisë absolute të Allahut.

وَمِنْ آيَاتِهِ ۖ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَأَخْتَلَفُ الْأَسْتِخْمَ وَالْوَنُكُمَ ۗ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ ﴿١١٠﴾  
=

*“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz.”* (err-Rrum, 22)

Këtë e dëshmon praktikisht historia e perandorive tona islame, në historinë tonë klasike dhe moderne.

- 4) **Refuzim, por jo bojkotim.** (الرفض لا المقاطعة) Islami ynë urdhëron për pranimin e së mirës, çfarëdo qoftë ajo, sidomos kur kemi parasysh

aprovimin e disa traditave të periudhës para islame, si: dhënia ushqim, nderimi i mysafirit, guximi, tavafi në Haxh, ecja ndërmjet Safasë dhe Merves etj. Allahu thotë:

= ﴿ وَمَا كَانَ صَلَاتُهُمْ عِنْدَ الْبَيْتِ إِلَّا مُكَاءً وَتَصَدِيَةً ۚ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ ﴾

*Lutja e tyre pranë shtëpisë (Qabesë) nuk ishte tjetër vetëm se britmë dhe duartrokkitje, prandaj vuajeni dënimin për shkak se mohoni.*“ (el-Enfalë, 35)

Kjo duhet të aplikohet edhe në jetën bashkëkohore tek muslimanët. Jo çdo gjë perëndimore është e refuzuar. Ne pranojmë të mirat, kuptohet gjithnjë sipas kriterit se ato nuk duhet të jenë në kundërshtim me fenë. Ne mund ta aplikojmë edhe kriterin e bojkotit, sidomos nëse vërejmë se ata janë duke e nënçmuar fenë tonë ose tallen me të, siç ka ndodhur këto vitet e fundit. Por, ajo që të çudit është se me gjithë këto marrëzi të Perëndimit dhe me gjithë këto shkelje të të drejtave tona që na bëhen prej tyre, prapëseprapë muslimanët vazhdojnë biznesin me ta, sikur të mos ketë ndodhur kurrgjë!!!

Si përfundim mund të themi se kjo është platforma sipas së cilës duhet të veprojmë me të tjerët.

Allahu e di më së miri!

=  
=  
=  
=  
=  
=  
=  
=



## Kapitulli VI:

# ARGUMENTET E TRANSPARECËS (TË QENIT I HAPUR) NË KULTURËN E MUSLIMANIT MODERN

---

Ajo që, para së gjithash, duam të konfirmojmë në këtë kapitull është se Kultura jonë nuk pranon në asnjë mënyrë të shkrihet në kulturat e tjera. Përkundrazi, ajo është kundër globalizmit arrogant dhe vesternizimit të egër, vetëm se ajo nuk është e izoluar. Ajo është e hapur, por me kriterë. Për ta diskutuar këtë çështje dhe për t'i dhënë asaj ngjyrë kur'anore, dijetarët kanë aluduar në disa prej karakteristikave të Kur'anit, si:

- 1) **Vërtetues, por edhe mbizotërues.** Allahu thotë:

= وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ ط

*“Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur'anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre...”* (el-Maide, 48)

Kur'ani ka ardhur për të vërtetuar por edhe për të qenë fjala e fundit për librat e mëparshme si dhe për t'i gjykuar ato, për shkak të devijimit nga ajo për çka ishin shpallur.

- 2) **Islami ka aprovuar dhe miratuar moralin e mirë, qoftë ai edhe i periudhës para islame.** Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] i pranonte tiparet e mira të periudhës paraislamike, kuptohet me modifikimet përkatëse. Haxhi është një nga shembujt e kësaj natyre, që mbeti si traditë

(obligim), por që u modifikua sipas Islamit. E tillë ishte puna edhe me martesën, që siç përmend Buhariu, ndahej në katër lloje të ndryshme, ndërsa Islami e aprovoi vetëm një prej tyre, atë që përputhet me natyrshmërinë. Hadithi, që është përmendur më parë, në të cilin thuhet se misioni i Muhammedit [alejhis salatu ves selam] ishte përsosja e moralit, është dëshmi përkatëse.

- 3) **Ligjësimi i përvetësimit nga të tjerët.** Dijetarët kanë lejuar që të përvetësojmë nga të tjerët gjëra që janë në dobi të muslimanëve, me kusht që ato të mos paraqesin kundërthënie me besimin, ligjet dhe moralin islam. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] kishte marrë një vulë për vulosjen e letrave të tij, ashtu siç bënin mbretërit e kohës. Sahabët [Allahu qoftë i kënaqur me ta!] i treguan se të huajt nuk e pranonin letrën nëse nuk ishte vulosur më parë. Në betejën e Ahzabit, me propozimin e Selmanit dhe disa sahabëve të tjerë, u bë hapja e hendekut. Kështu ndodhi edhe me regjistrat shtetërorë dhe kalendarin nga Omeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Sigurisht, ajeti kur'anor:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاهُمْ مِّنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاهُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۗ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”* (el-Huxhurat, 13)

... aludon për këtë, ngase njoftimi ndërkulturor nënkupton edhe shkëmbimin në të gjitha fushat, me përjashtim të besimit, ligjeve fetare dhe moralit. Në të kaluarën, shkëmbimi ishte bilateral, ndërsa sot, fatkeqësisht, janë muslimanët ata që marrin dhe nuk japin asgjë. Ata janë ndikuar shumë nga morali, sjelljet dhe traditat e perëndimorëve.<sup>58</sup>

- 4) **Ligjet (fetë) para Islamit.** Ligji paraprak, përshkrimi i të cilit është bërë në Kur'an, nëse nuk kemi ndonjë ligj tonin që e ndalon, pranohet. Ky është

<sup>58</sup> Ibid.

rregull tek usulistët, ndryshe figurimi i tij në Kur'an do të ishte i pakuptimtë. Si shembull të kësaj natyre do të merrnim kriterin, për përzgjedhjen e të propozuarve për vendet e punëve me përgjegjësi, që të jenë besnikë dhe të fuqishëm, kriter ky i marrë nga ligjet e kësaj natyre. Allahu, duke përshkruar fjalët e vajzës së burrit të moshuar, thotë:

= ﴿٢٦﴾ قَالَتْ إِحْدَاهُمَا يَا أَبَتِ اسْتَجِرْهُ <sup>ط</sup> إِنَّ خَيْرَ مَن اسْتَجَرْتَ الْقَوِيُّ الْأَمِينُ

*"Njëra prej atyre të dyjave tha: "O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku!"* (el-Kasas, 26)

I ngjashëm është edhe rrëfimi i mbretit Talut me çifutët. Allahu thotë:

وَقَالَ لَهُمْ نَبِيُّهُمْ إِنَّ اللَّهَ قَدْ بَعَثَ لَكُمْ طَالُوتَ مَلِكًا قَالُوا أَنَّى يَكُونُ لَهُ الْمُلْكُ عَلَيْنَا

وَنَحْنُ أَحَقُّ بِالْمُلْكِ مِنْهُ وَلَمْ يُؤْتَ سَعَةً مِّنَ الْمَالِ قَالَ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاهُ عَلَيْكُمْ وَزَادَهُ

= ﴿٢٧﴾ بَسْطَةً فِي الْعِلْمِ وَالْجِسْمِ وَاللَّهُ يُؤْتِي مَلَكَهُ مَن يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ

*"Pejgamberi i tyre u tha: "All-llahu caktoi sundues tuajin Talutin". Ata thanë: "Si mund të jetë ai sundues yni, kur ne kemi më shumë meritë se ai për sundim, madje ai edhe nuk është i pasur"? Ai tha: "All-llahu e zgjodhi atë sundues tuajin dhe e pajisi me dituri të gjerë e me fuqi trupore"! All-llahu ia jep sundimin e vet atij që do, All-llahu është dhurues i madh, i dijshëm."* (el-Bekare, 247)

Mbreti, për të qenë i aftë që ta udhëheqë vendin dhe njerëzit, duhet t'i ketë këto cilësi - kanë thënë disa dijetarë. Nga kaptina Jusuf dijetarët kanë përfituar rregulla shumë me rëndësi, me të cilat normalizohen kushtet e jetës, dhe jo vetëm kaq, por kanë nxjerrë edhe rregulla që kanë të bëjnë me të drejtat e individit. Allahu thotë:

= ﴿٤٧﴾ قَالَ تَزْرَعُونَ سَبْعَ سِنِينَ دَابًّا فَمَا حَصَدْتُمْ فَذَرُوهُ فِي سُنْبُلِهِ إِلَّا قَلِيلًا مِّمَّا تَأْكُلُونَ ﴿٤٧﴾

*Ai (Jusufi) tha: "Mbillni shtatë vjet vazhdimisht, e çka keni korrur lëreni në kallinj, përveç një pakice nga e cila do të hani."* (Jusuf, 47)

وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ يَتَّبِعُوا مِنْهَا حَيْثُ يَشَاءُ <sup>ط</sup> نَصِيبٌ بِرَحْمَتِنَا مَن نَّشَاءُ <sup>ط</sup> وَلَا نُضِيعُ

أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٦﴾ =

*Dhe kështu Ne Jusufit i dhamë pozitë në vend (në Egjipt) zinte vend aty ku dëshironte. Ne e pajisim me të mirat tona atë që duam, e Ne nuk ua humbim shpërblimin punëmirëve.” (Jusuf, 55)<sup>59</sup>*

- 5) **Urtësia duhet të merret ngado që të vijë.** Muslimani i ditur e di se është kërkesë dhe urdhër i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij [alejhis salatu ves selam] hulumtimi i së vërtetës, qoftë në natyrë dhe gjithësi, qoftë në vetë njeriun dhe historinë e tij. Allahu i Madhëruar thotë:

وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِّلْمُوقِنِينَ ﴿٢١﴾ وَفِي أَنفُسِكُمْ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿٢٢﴾ =

*“Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit. 21. Po edhe në veten tuaj. A nuk po e shihni?” (edh-Dharijat, 20-21)*

سُرِّيهِمْ ءَايَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۗ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ

كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٢٣﴾

*“Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” (Fussilet, 53)*

Kur'ani na mëson se të vërtetën mund ta thonë edhe jomuslimanët dhe se kriteri për marrjen e saj nuk është vetë folësi, por është vetë urtësia. Allahu, duke përshkruar fjalët e Belkizës dhe të gruas së sundimtarit të Egjiptit, thotë:

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ أَفْتُونِي فِي أَمْرِي مَا كُنتُ قَاطِعَةً أَمْرًا حَتَّىٰ تَشْهَدُونِ

*“Ajo tha: “O ju pari, më sugjeroni në këtë çështje timën se unë nuk do të vendosi asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqim!” (En Neml:32)*

وَمَا أُبْرئُ نَفْسِي ۚ إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ ۗ إِلَّا مَا رَحِمَ رَبِّي ۗ إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ رَّحِيمٌ =

*“Unë nuk e shfajsoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveq*

<sup>59</sup> Kardavi, Jusuf. *Thekafetuna bejne-l-infitahi ve-l-ingilak*. F. 38-43; *Thekafetu-d-daijeh*. 52-72.

atë që ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron shumë” ( Jusuf:53)

Të vërtetën mund ta thotë madje edhe një hipokrit. Muhammedi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:

إياكم وما ابتدع، فإن ما ابتدع ضلالة، وأحذركم من زيغ الحكيم، فالشيطان قد يقول كلمة الضلالة على  
لسان الحكيم، وقد يقول المنافق كلمة الحق

Keni kujdes nga ajo që është shpikur, ngase e shpikura është humbje. Ua tërheq vërejtjen që të jeni të vëmendshëm ndaj lajthitjes së sundimtarit, ngase djalli mund ta thotë fjalën e humbjes nëpërmjet gjuhës së tij, ndërsa të vërtetën ndodh ta thotë edhe hipokriti. ”<sup>60</sup>

- 6) **Kulturë e mirëpritjes së dialogut.** Kur’ani Fisnik është plot me përshkrime të dialogëve të pejgamberëve me popujt e tyre, si Ibrahimimi [alejhis selam] me popullin e vet në kaptinat el-En’amë, el-Enbija dhe esh-Shuara; me babanë e vet në kaptinën Merjem; Shuajbi [alejhis selam] me popullin e vet në kaptinën Hud; Musa [alejhis selam] me faraonin etj. Pastaj, dialogu i melaikeve me Allahun, siç thotë Allahu:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلٰٓئِكَةِ اِنِّىْ جَاعِلٌ فِى الْاَرْضِ خَلِيْفَةً ۗ قَالُوْۤا اَتَجْعَلُ فِىْهَا مَنْ يُّفْسِدُ فِىْهَا  
وَيَسْفِكُ الدِّمَآءَ وَحَنُنٌ نُّسِيْحٌ بِحَمْدِكَ وَنُقَدِّسُ لَكَ ۗ قَالَ اِنِّىْۤ اَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُوْنَ ﴿ۙ﴾ =


“(Përkujto Muhammed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!" Ata thanë: "A do të vësh në të atë që bën çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini!" (el-Bekare, 30)

إِذْ قَالَ لِاٰبِيْهِ يٰٓاَبَتِ لِمَ تَعْبُدُ مَا لَا يَسْمَعُ وَلَا يُبْصِرُ وَلَا يُغْنِيْ عَنْكَ شَيْئًا ﴿ۙ﴾ =

“Kur babait të vet i tha: "O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh, e as nuk ke asgjë prej tij?" (Merjem, 42)

وَإِذْ قَالَ مُوسٰٓى لِقَوْمِهٖۙ اِنَّ اللّٰهَ يٰٓاْمُرُكُمْۙ اَنْ تَذٰنِحُوْۤا بِقَرَّةٍ ۗ قَالُوْۤا اَتَتَّخِذُنَا هٰٓزُوْۤا ۗ قَالَ اَعُوْذُ بِاللّٰهِ

<sup>60</sup> Ibid, f. 38-43.

=  أَنْ أَكُونَ مِنَ الْجَاهِلِينَ

“(Përkujtoni) Edhe kur Musai popullit të vet i tha: "All-llahu ju urdhëron ta therrni një lopë! Ata thanë: "A bën tallje me ne"? Ai tha: "All-llahut i mbështetem të më ruajë e të mos bëhem nga injorantët!" (el-Bekare, 67)

- 7) **Kulturë e cila beson në ripërtëritje.** Muhammedi [alejhis salatu ves selam] ka thënë:

إن الله يبعث لهذه الأمة على رأس كل مائة سنة من يجدد لها دينها“

Në çdo kryeshekull, Allahu i dërgon këtij ummeti një ripërtëritës të fesë!<sup>61</sup>

Ripërtëritja ndodh me ripërtëritjen e të kuptuarit, besuarit, vepruarit, përmbajturit parimeve të saj dhe thirrjes në to. [Pra, është një përtëritje që nënkupton kthimin në baza.] Historia islame është përplot reformatorë, si: Halifeja i drejtë Umer Ibn Abdul Azizi, Imam Shafiu, që themeloi Shkencën e Usulit, Imam Gazali që ngjalli shkencat fetare, Ibni Tejmije, Ibnul Kajjimi etj. Ripërtëritja në fe duhet patjetër të kryhet me mjetet e saj, prej dijetarëve të saj dhe prej njerëzve që janë kompetentë<sup>62</sup>, pra që kanë dije dhe njohuri e jo që njihen nga rrobat a diplomat. Edhe koha jonë ka pasur dhe ka të tillë, si: Ibni Bazi, Ibni Uthejmini, Ebul Hasen Nedeviu, Mevdudi, Sejjid Kutbi, Reshid Rida, Albani, Abdul Kadir Arnauti, Muhammed Gazali etj. Ndërsa prej atyre që janë ende gjallë, mund të përmendim dijetarë të tillë si: Dr. Jusuf el-Kardavi, Shuajb Arnauti, Selman Audeh, Aid Karni, Salah Abdul Fettah Halidi, Fehd ibn AbduRRahman Rumi, Muhammed Muhtar Shenkiti, Muhammed Ali Sabuni, AbduRrahman Sudejsi, Muhammed Arifi, Muhammed Adnan Zurzur, Muhammed Seid Ramadan Buti etj.

<sup>61</sup> E transmeton Ebu Davudi në Sunen, nr. 4291 ndërsa Albani e vlerëson autentik.

<sup>62</sup> Eba Husejn, Fehd ibn Sa'd. (1428) *Kejfe nefhem et-tejsir – vakafat mea kitab "If'al ve la harexh"*, f. 109-111.

## **Kapitulli VII:**

# **KRITERET E TË QENIT I HAPUR – VIJA QË NUK BËN TË SHKELET**

---

Këtë kapitull e kemi lënë të veçantë për të shpjeguar se të qenit i hapur megjithatë ka kushte. Nuk do të donim të konsideroheshim si propagandues të liberalizmit dhe nuk jemi. Ndaj, këtu do të përmendim disa nga kushtet dhe kriteret e vëna për të qenë i hapur karshi tjetrit. Dijetarët muslimanë kanë tërhequr vërejtjen për:

- 1) Pjekurinë e duhur, ndryshe jo çdokush mund të shfaqet i hapur ndaj kulturës, ideve dhe bindjeve të të tjerëve, ngase shumë shpejt do të përfundonte si viktimë e rrymave fetare (misionarizmit të krishterë) apo e shekullarizmit. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam], siç transmetohet, e kishte ndaluar Omerin të lexonte disa fletushka të Teuratit, nga frika e mbjelljes së dyshimeve apo përzierjes së gjërave, pasi që ai edhe ashtu ishte ende shumë i ri në Islam. Bazuar në këtë, dijetarët kanë këshilluar për të mos i dërguar fëmijët të vegjël jashtë vendit pa u pjekur apo pa përfunduar më parë studimet në vend. Po kështu porosisim dhe sot që të mos tregohemi shumë tolerantë edhe karshi disa kanaleve televizive, dëmi i të cilave veç po dëshmohet për familjen dhe rininë. Personalisht kam parë pjesëmarrjen e disa thirrësve të rinj muslimanë në debate televizive, që fatkeqësisht, për shkak të mospërgatitjes profesionale, dështonin. Ata nuk

janë për vende të tilla, prandaj le të kenë kujdes se kriteri i përzgjedhjes nga televizionet bëhet edhe për shkak të jokualifikimit të nevojshëm. Po qe se do të hulumtonin për dimensionet dhe domethëniet ideore dhe shkencore të ajeteve, atëherë për rastin në fjalë shumë të aplikueshme do të na dilnin ato të ajeteve vijuese:

= يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا خُذُوا حِذْرَكُمْ فَانفِرُوا ثُبَاتٍ أَوْ اَنْفِرُوا جَمِيعًا ﴿٧١﴾

*“O ju që besuat, rrini të përgatitur (të armatosur) dhe dilni (për në luftë) grup pas grupi apo të gjithë së bashku.” (en-Nisa, 71)*

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهَبُونَ بِهِ ءَعَدُّوا لِلَّهِ وَعَدُّوْكُمْ

وَأَآخِرِينَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ يَعْلَمُهُمْ ۗ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوَفَّ

إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تَظْلَمُونَ ﴿٦١﴾ =

*“E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Çkado që shpenzoni për rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë.” (el-Enfalë, 60)*

- 2) Vërejtje tjetër që kanë dhënë dijetarët është dhe ikja nga të qenit i hapur pa asnjë kusht. Disa vetëm marrin nga kulturat e tjera, pa dalluar të mirën nga e keqja, të dobishmen nga e dëmshmja, të nevojshmen nga e panevojshmjja, atë që përputhet me Kur’anin dhe Sunnetin dhe atë që nuk përputhet. Ummeti ka një përvojë të hidhur nga e kaluara kur e kishte neglizhuar këtë kriter. Për pasojë, librat fetare ishin përplot thënie – israilijate – që ndonjëherë mbase edhe ishin në kundërshtim të hapur me fenë. Kur’ani na ka tërhequr vërejtjen për shtrembërimet që ata – veçanërisht çifutët – iu kanë bërë librave të tyre, andaj nuk mund të presim se do të jenë zemërmirë ndaj nesh.

﴿ أَفَتَطْمَعُونَ أَنْ يُؤْمِنُوا لَكُمْ وَقَدْ كَانَ فَرِيقٌ مِّنْهُمْ يَسْمَعُونَ كَلِمَ اللَّهِ ثُمَّ تُحَرَّفُونَهُ مِنْ بَعْدِ



= ﴿٧٥﴾ مَا عَقَلُوهُ وَهُمْ يَعْلَمُونَ

*“A shpresoni se do t'u besojnë ata juve (jehuditë), kur dihet se një grup prej tyre dëgjuan fjalët e All-llahut, edhe pse i kishin kuptuar, e duke qenë të vetëdijshtëm (ç'bënin) i ndryshuan ato?” (el-Bekare, 75)*

وَدَّ كَثِيرٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَوْ يَرُدُّونَكُمْ مِن بَعْدِ إِيمَانِكُمْ كُفَّارًا حَسَدًا مِّنْ عِنْدِ أَنفُسِهِمْ

مِّنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ الْحَقُّ فَاعْفُوا وَاصْفَحُوا حَتَّىٰ يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ

= ﴿١٦﴾ قَدِيرٌ

*“Shumë ithtarë të librit (jehudi, të krishterë) edhe pasi u është bërë e qartë e vërteta, nga vetë zilia e tyre personale dëshiruan që pas besimit tuaj t'iu kthejnë në mosbesimtarë, pra ju lini dhe largohuni prej tyre derisa All-llahu ta sjellë urdhrin e vet. All-llahu ka mundësi për çdo send.” (el-Bekare, 109)*

Nga ajetet e mësipërme, përveç asaj që kuptojmë se çfarë kanë bërë ithtarët e librit dhe si kanë vepruar me librat e tyre, mësojmë dhe për përpjekjet e vazhdueshme të tyre për devijimin e njerëzve dhe lajthitjen e tyre nga rruga e vërtetë, përpjekje të cilat nuk kanë mbaruar edhe sot e kësaj dite. Profesori dhe Hoxha im i dashur, i cili tashmë ka kaluar në amshim, Dr. Abdul Kahhar el-Ani, bënte thirrje për ta larguar nga përdorimi llojin e israilijateve, me arsyetimin se nuk ka të specializuar të mjaftueshëm në historisë islame moderne dhe se hulumtuesit e studimeve kur'anore nuk janë shumë të vëmendshëm karshi israilijateve. Paramendoni, nëse edhe në kohën e Shejhul Islam Ibni Tejmijes nuk ka pasur dijetarë të mjaftueshëm për historinë e çifutëve, atëherë çfarë mund të thuhet për sot?! Më e rrugës është që të mjaftohemi me Kur'anin.<sup>63</sup>

- 3) Magjepsja (mashtrimi) nga kultura e tjetrit është e ndaluar. Të ndihesh sikur je i pavlerë karshi tjetrit është gabim. Të mendosh e besosh se ajo që thotë tjetri është e qëlluar, ndërsa fjala jote jo, se ajo që bën tjetri është e

<sup>63</sup> Ja'kub, Tahir Mahmud Muhammed. (1425) *Esbabu-l-hatai fi-t-tefsir – dirasetun te'silijeh*. 1/80-351.

mirë ndërsa ajo që bën ti jo, se ajo që thotë tjetri është e vërtetë kurse ajo që thua ti jo, se ajo që propozon tjetri është e saktë kurse ajo që propozon ti jo, se ajo... se kjo... – është një lloj adhurimi, me fjalë apo vepër. Fatkeqësisht, ky skenar – nëse mund ta quaj kështu - është përsëritur dy herë në ummet: atëherë kur u përkthye filozofia greke dhe njerëzit u mashtruan dhe u dhanë pas saj, dhe tani kur kultura perëndimore ka vërshuar botën. Shkaktar kryesor i kësaj gjendjeje të mjerë është injoranca e muslimanëve dhe prapambetja e tyre në zhvillimin teknologjik. Sigurisht, faji i faturohet botëkuptimeve të gabuara që kanë përvetësuar. Më qartë, *kaderin* (caktimin e Allahut) e kuptuan si imponim, mbështetjen (tevekkulin) si varësi (tevakul), kënaqësinë (ar. el-kinaah) e kuptuan si pajtim me asgjë, durimin si nënshtrim ndaj tiranëve, devotshmërinë si dervishllëk, zuhdin (asketizmin) si braktisje të jetës, *shuranë* (konsultimin në nivel të lartë shtetëror) si simbol, jo si të detyrueshëm, pozitën e burrit për ta shtypur gruan...

- 4) Fatkeqësisht, ndikimi i kulturës perëndimore sot është shumë i theksuar, madje tek të gjitha shtresat e shoqërisë. Ky informacion është një alarm për thirrësit (hoxhallarët) për të reaguar kundër, gjithnjë sipas kriterëve të përmendura më parë në këtë studim.<sup>64</sup> Ka humbur xhelozia për fenë. Sot, pa fije turpi, në televizionet tona transmetohen seriale latine e turke, përmbajtja e të cilave është degjenerim dhe thirrje për shthurje. Ku janë mbrojtësit e Islamit dhe rojet e besimit?!

Allahun e kam Ndhimës dhe Ai më mjafton! Fundin e këtij kapitulli do ta përmbyll me citimin e disa ajeteve kur'anore, të cilat thërrasin për t'i zhdukur këto botëkuptime të gabuara dhe vlera të prishura perëndimore nga shoqëria jonë.

= ﴿لَا يَحْزُنكَ قَوْلُهُمْ إِنَّ الْعِزَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ﴾

*“Po ty mos të të mendojnë thëniet e tyre. E tërë fuqia dhe ngadhënjimi i takon vetëm All-llahut. Ai i dëgjon dhe i di të gjitha.”* (Junus, 65)

<sup>64</sup> Kardavi, Jusuf. *Thekafetuna bejne-l-infitahi ve-l-ingilak*, f. 71-79; Badehdah, Ali Umer. (1425) *Eth-thekafetu el-islamijetu*, f. 85-103.

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعِزَّةَ فَلِلَّهِ الْعِزَّةُ جَمِيعًا ۚ إِلَيْهِ يَصْعَدُ الْكَلِمُ الطَّيِّبُ وَالْعَمَلُ الصَّالِحُ يَرْفَعُهُ ۚ  
 وَالَّذِينَ يَمْكُرُونَ السَّيِّئَاتِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ ۖ وَمَكْرُ أُولَئِكَ هُوَ يَبُورُ ﴿١٠﴾ =

*“Kush e dëshiron krenarinë (le ta dijë), e tërë krenaria i takon All-llahut (pra le të kërkojë prej Tij), tek Ai ngrihet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë, e Ai i pranon. E ata që përgatitin dredhi të këqija, për ata është një dënim i rëndë dhe dredhia e tyre është e zhdukur.” (Fatir, 10)*

﴿ يَتَأْتِيَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَرَىٰ أَوْلِيَاءَ ۚ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ۚ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ  
 مِّنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٥١﴾ =

*“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk e vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar.” (el-Maide, 51)*

وَلَا تَرْكَبُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ وَمَا لَكُمْ مِّنْ دُونِ اللَّهِ مِّنْ أَوْلِيَاءَ ثُمَّ لَا  
 تُنصَرُونَ ﴿١٣﴾ =

*“Dhe mos anoni nga ata që bënë zullum, e për atë shkak t'ju kapë zjarri, sepse përveç All-llahut nuk keni mbrojtës, e mbeteni të pandihmuar.” (Hud, 113)*

Allahu e di më së miri!

## Përmbyllje

---

Në mbarim të këtij punimi, nuk kam si të mos e falënderoj Allahun për përgatitjen e këtij punimi dhe publikimin e tij në këtë formë. Sigurisht, do të doja të shprehja falënderime të përzemërta dhe shumë të veçanta për dy kolegët e mi, për dy profesorët nga Turqia, Prof. Dr. Ali Ihsanin dhe Prof. Dr. Muhammed Aydin-in, ligjërues në Fakultetin e Studimeve Islame në Universitetin e Katarit, pa vërejtjet, këshillat dhe sugjerimet e të cilëve punimi nuk do të ishte i këtillë çfarë është. E lus Allahun t'i shpërblejë me mirësitë e Tij në këtë botë dhe në botën tjetër! Amin!

### Rezultatet e punimit

Punimi zbardh kontributin e pashoq që dijetarët dhe mendimtarët muslimanë kanë dhënë në fushën e shpjegimeve gjuhësore dhe terminologjike të kulturës si dhe të lidhjeve dhe raporteve të saj me fenë, shkencën, qytetërimin, civilizimin dhe kulturat e tjera përreth.

Studimi pasqyron vlerat, botëkuptimet e larta të fesë dhe besimit, si dhe veçoritë hyjnore me të cilat shquhet Kultura Islame.

Studimi demonstroi fuqinë dhe aftësinë e Kulturës Islame për bashkëveprim kulturor dhe të qenit në hap me ngjarjet dhe zhvillimet bashkëkohore.

Studimi vërteton madhësinë e kësaj feje, respektivisht të burimeve të saj, Kur'anit, Sunnetit, traditës së të parëve, në qasjen, ndikimin dhe kontrollimin e sjelljeve (të individit), por edhe formësimin e përgjithshëm të kulturës së muslimanit bashkëkohor.

Studimi hedh dritë edhe mbi bazat, shtyllat dhe principet e kulturës së muslimanit bashkëkohor.

Kultura jonë islame, me këto baza, principe dhe veçori, është e vetmja që meriton të jetë kulturë për çdo kohë dhe vend.

Allahun e lusim për falje dhe mirësi!

Dr. Hajredin HOXHA

## Bibliografia:

Kur'ani Fisnik.

1. Abdul Hakk Ibn Hakki Turkmani & Fet'hi Ibn Abdullah el-Musuli. (2010) *Et-teamul mea gajril muslimine fi-s-sunneti-n-nebevijeh*. Çmimi ndërkombëtar për Sunnetin dhe Studimet Islame Najif Ibn Abdul Aziz Al Suud.
2. Amidi. (2008) *El-ihkam fi usuli el-ahkam*. Bejrut: Darul ilmi lil melajin.
3. Azam, Abdul Aziz Muhammed. (2005) *El-kavaid el-fikhijeh*. Kajro: Darul hadith.
4. Badehdah, Ali Umer. (1425) *Eth-thekafetu el-islamijetu*. Xhidde: Daru Hafidh.
5. Izetbegoviq, Alija. (1994) *El-Islamu bejne-sherki ve-l-garbi*. Bejrut: Muessesetu-l-ilmi-l-hadith.
6. Buti, Muhammed Seid Ramadan. (1997) *Kubra el-jekinijjat el-keunijeh*. Damask: Daru-l-fikr.
7. Devle, Muhammed Ali. (2001) *El-jehud el-mu'tedune ve devletuhum Israil fi muel-lefati Muhammed el-Gazali*. Bejrut: Ed-dar esh-shamijeh.
8. Eba Husejn, Fehd ibn Sa'd. (1428) *Kejfe nefhem et-tejsir - vakafat mea kitab "If'al ve la harexh"*. Rijad: Daru-l-muhaddith.
9. El-Eshkar, Omer Sulejman. (2001) *Nahve thekafetin islamijjetin esileh*. Aman: Daru-n-nefais.
10. Fajiz, Habis. *Eth-thekafetu el-islamijeh II*. Xhidde: Universiteti Mbreti Abdul Aziz.
11. Gazali, Ebu Hamid. (2006) *El-mustasfa*. Demam: Daru Ibnil Xheuzijj.
12. Gazali, Muhammed. (1996) *Kejfe neteamel mea-l-Kur'an*. Kajro: Darul ma'rifeh.
13. Gazali, Muhammed. (1995) *Es-Sunnetu en-nebevijeh bejne ehli-l-fikhi ve-l-hadith*. Bejrut: Darul ma'rifeh.
14. Gazali, Muhammed. (2004) *Dusturu-l-vahdeti-th-thekafijeh bejne-l-muslimine*. Damask: Darul kalem.
15. Gazali, Muhammed. (2003) *Ilel ve edvijeh*. Damask: Darul kalem.
16. Gazali, Muhammed. (2005) *Sirr-rru te'ehhuri-l-arab ve-l-muslimine*. Damask:

Darul kalem.

17. Hasen, Dijauddin Atar. (2002) *El-mu'xhizetu-l-halideh*. Xhinde: Daru nuri-l-mektebat.
18. Ibni Mendhur, Xhemaluddin Ibn Mukrem. (...) *Lisanu-l-arab*. Bejrut: Daru sadir.
19. Ibni Zekerijja, Ebu-l-Hasen Ahmed Ibn Faris. (1999) *Mu'xhemu mekajisi-l-lugah*. Daru-l-xhil.
20. Ja'kub, Tahir Mahmud Muhammed. (1425) *Esbabu-l-hatai fi-t-tefsir – dirasetun te'silijeh*. Demam: Daru Ibni-l-Xheuzijeh.
21. Kardavi, Jusuf. (1993) *Melamih el-muxhetmea el-islamijj el-ledhi nenshuduhu*. Kajro: Mektebetu vehbe.
22. Kardavi, Jusuf. (1997) *El-Hasais el-ammeh li-l-Islam*. Bejrut: Muessesetu-rr – rrisaleh.
23. Kardavi, Jusuf. (2001) *Kejfe neteamel mea-l-Kur'an*. Bejrut: Muessesetu-rr – rrisaleh.
24. Kardavi, Jusuf. (2005) *Mebadi fi-l-hivari ve-t-takribi bejne-l-medhahib el-islamijjeh*. Kajro: Mektebetu vehbe.
25. Kardavi, Jusuf. (2005) *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*. Kajro: Darush shuruk.
26. Kardavi, Jusuf. (2010) *Thekafetu-d-daijeh*. Kajro: Mektebetu vehbe.
27. Kattan, Mennaë. (1999) *Mebahith fi ulumi-l-Kur'an*. Rijad: Darul mearif.
28. Lahim, Halid Ibn Abdul Kerim. (2004) *Mefatih tedeburi-l-Kur'an ve-n-nexhahi fi-l-hajat*. Rijad.
29. Mursafi, Seid. (2005) *Eth-thekafetu el-islamijjeh ve etheruha fi tekvini-sh-shahsijjeti-l-islamijjeh*. Mensure: Darul jekim.
30. Muslim, Mustafa. (2004) *Eth-thekafetu el-islamijjeh: ta'rifuha, mesadiruha, mexhalatuha, tehaddijatuha*. Bejrut: Muesseseturr rrisaleh.
31. Musned el-Imam Ahmed. Damask; Darul aklem. 19990.
32. Mustafa, Nadije Mahmud. (2006) *Hasaisu eth-thekafeti-l-arabijjeeti ve-l-islamijjeti*. Kajro: Darus selam.
33. Nevakis fi-l-kitabetejni el-ferensijjeti ve-l-inkilizijjeeh Katar: Ministria e vakëfit.
34. Sahihu i Buhariut. Bejrut: Darul fikr. 2003.
35. Sahihu Muslim. Bejrut: Darul fikr. 2004.

36. Salah Abdul Fettah. (2002) *Amerika min ed-dahil bi-mindhari Sejjid Kutb*. Damask: Darul kalem.
37. Salih Hindi dhe të tjerë. (2000) *Eth-thekafetu el-islamijeh*. Amman: Darul fikr.
38. Samarkandi, Muhjiddin Ibn Kudret. (2008) *Taksim-u-s-Sunneh ila teshriijeh ve gajru teshriijeh*. Bejrut: Darul kutub el-ilmijeh.
39. Seid, Hemma & Halidi, Salah. (2002) *El-vevhiz fi-th-thekafeti-l-islamijeh*. Amman: Darul fikr.
40. Sunejdi, Selman Ibn Omer. (2001) *Tedebbur el-Kur'an*. Revista el-Bejan.
41. Shatibi, Ebu Is'hak el-Garnati. (2004) *El-muvafekat fi usuli-sh-Sheriah*. Bejrut: Daru-l-kutub el-ilmijeh.
42. Shenkiti, Muhammed Muhtar. (2007) *Tefsiru advai-l-bejan*. Bejrut: Muessesetu-rr-rrisaleh.
43. Ulvan, Abdullah Nasih. (2002) *Esh-shebab el-muslim fi muvaxheheti-t-tehaddijat*. Damask: Darul kalem.
44. Xherisheh, Ali. (1979) *Esalibu-l-gazvi-l-fikrij li-l-alemi-l-islamij*. Medine: Daru-l-vefaë.
45. Xhunejdi, Abdullah Shakir. (2004) *Muhadaratun fi-th-thekafeti-l-islamijeh*. Hail: Daru-l-Endelus.
46. Yalçin, Mikdad. (1999) *Subulu-n-nuhud bi-t-tullabi ulukijjen ve ilmijjen ila musteva ehdafe-l-ummeh*. Saudi: Darul kutub el-alemijeh.
47. Yalçin, Mikdad. (2004) *Terbijjetul exhjal ala ahlakijjati ve arabi el-munakasheti vel muhavereti vel munadharetil ilmijeh*. Saudi: Darul kutub el-alemijeh.
48. Zerkani, Abdu-l-Adhim. (1999) *Menahil el-urfan fi ulumi-l-Kur'an*. Bejrut: Daru-l-melajin.